

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave në: “Inxhinieri kompjuterike”

Ofruar nga Universiteti “Epoka”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Ermira MEZINI

Dr. Alketa GREPCKA

Shtator / 2018




RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Msc në Inxhinieri kompjuterike, Universiteti “Epoka”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IALAplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.908 date 26.08.2009
4	Vendim i Bordit të Akreditimit (Akreditim i parë)	Urdhër Nr. 286, datë 06.07.2012.
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieri kompjuterike”
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët/ Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Numri i studentëve	26

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE




Grupi i Vlerësimit të Jashtëm këtu e mëposhtë emërtuar “GVJ” përbëhet nga ekspertët përkatësisht Prof.Dr. Ermira Mezini dhe Dr. Alketa Grepcka. Grupi i vlerësimit është angazhuar nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (SCAL) për të bërë vlerësimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” në Universitetin “Epoka”.


Veprimtaria e GVJ në procesin e vlerësimit :

GVJ paraprakisht u njoh me RVB të përgatitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm në UE përbërja e të cilit është si më poshtë vijon:

1. Dr. Arban Uka – kryetar
 2. Dr. Elton Domnori – anëtar
 3. Dr. Endri Soja – anëtar
 4. Dr. Ali Osman Topal-anetar
 5. Dr. Julian Hoxha –anetar
 6. Znj. Xhoena Polisi
 7. Znj. Fatjona Halaj
- GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin bazë të dorëzuar nga Universiteti “Epoka” që mbështet aktivitetin e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”
 - Takime me grupe të ndryshme roli i të cilave është i rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”. Sipas një axhende të përgatitur dhe të rënë dakord nga ana jonë si ekspertë, nga ana e përfaqësuesve të “Epoka University” dhe përfaqësuesve të institucionit ASCAL u zhvilluan gjatë datës 12.06.2018 dhe 14.06.2018 takime të ndryshme. Vlen të përmenden takimi me Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përgjegjës in e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, Takim me grupin e vetvlerësimit të programit të studimit, takim me stafin e programit të studimit, intervista me studentët, takim me Zyrën e Hulumtimit dhe të Projekteve, takim me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë, takim me zyrën e karrierës dhe alumni.
 - Një vëmendje GVJ i dha edhe vizitës në terren. Gjatë vizitës në terren GVJ verifikoi të dhënat e theksuara në RVB në lidhje me infrastrukturën, sallat e leksione, seminareve, laboratorët, sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerezore.
 - Në përfundim bazuar mbi të dhënat e mbledhura GVJ hartoi edhe raportin perfudimtar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Msc. në Inxhinieri Kompjuterike. Në raport, është paraqitur mendimi i pavaruar i GVJ për shkallën e plotësimin të standarteve shtetërore të cilësisë të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike. Në vecanti puna e GVJ konsiston në vlerësimin e punës së Universitetit “Epoka” në lidhje me plotësimin e rekomandimeve të bëra nga BA lidhur me këtë program.

TË DHENA TË PERGJITHSHME NË LIDHJE ME PROGRAMIN Msc. “INXHINIERI KOMPJUTERIKE”

Universiteti “EPOKA” përbëhet nga tre fakultete:



1. Fakulteti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë, i përbërë nga:

- Departamenti i Arkitekturës;
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, i përbërë nga:

- Departamenti i Financë Bankë;
- Departamenti i Administrim Biznesit;
- Departamenti i Ekonomiksit;

3. Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Sociale, i përbërë nga:

- Departamenti i Drejtësisë;
- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Qendra për Studime Europiane.

Universiteti "EPOKA" ofron arsim në tre cikle studimi, përkatësisht Bachelor, Master dhe Doktoratë, me 10 programe Bachelor, 9 programe Master të Shkencave, 7 programe Master Profesional, 2 programe të Integruara të Ciklit të Dytë dhe 6 programe studimi Dokorate. Gjuha e mësimdhënies në të gjitha programet e studimit është ajo angleze, me përjashtim të programit të studimit Bachelor në Bankë-Financë, që ofrohet edhe në shqip.

Programi i studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 908, datë 26.08.2009 dhe ka marrë akreditimin e parë me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 286, datë 06.07.2012.

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike zhvillohet në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike.

Ndryshime në emërtim dhe strukturë:

Në vitin 2012, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 553, datë 22.08.2012, statusi ligjor i institucionit është ndryshuar nga "Institucion i Arsimit të Lartë ("Shkollë e Lartë") në "Universitet".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Ermira MEZINI

2. Dr. Alketa GREPCKA

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli

Universiteti Epoka është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.09.2018, përmes sistemit AMS. UE përcjell përmes sistemit më datë 13.09.2018 dhe në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 261/30 Prot, datë 13.09.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 339, datë 08.06.2012 janë dhënë edhe rekomandimet e mëposhtme të cilat janë edhe subjekt vlerësimi i jashtëm i GVJ.

1. Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa mësimore e mësimdhënies nga stafi akademik.
2. Të shikohet mundësia e ofrimit të mësimdhënies pjesërisht në gjuhën shqipe.
3. Të intensifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të pranuar, duke përdorur politika më efektive marketingu.
4. Numri i përgjithshëm i disiplinave, të jetë më i kufizuar dhe i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentët të jenë më komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.
5. Puna individuale e studentëve duhet të stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve të ndryshme.
6. Rekomandohet që të dhënat e përfituara nga KVAPC të analizohen dhe të bëhen pjesë më e drejtpërdrejtë e menaxhimit akademik dhe administrativ të IAL.
7. Një profilizim më i qartë i stafit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies.
8. Të vazhdohet puna e nisur me për bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke institucionalizuar ato me marrëveshjeve të qëndrueshme edhe në trojet shqiptare
9. Të rritet bashkëpunimi me ndërmarrjet prodhuese lider në drejtimet përkatëse si Brenda vendit ashtu edhe në rajon.
10. Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor dhe të zgjerohet pjesëmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare.
11. Literatura shkencore vendase dhe e huaj në bibliotekë është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.
12. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. **Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa mësimore e mësimdhënies nga stafi akademik.**

Universiteti “Epoka” zbaton direktivat “Mbi ngarkesën e stafit akademik”. Ky udhëzues është i bazuar në kontratat e punës së stafit me kohë të plotë dhe të pjesëshme [aneks 11, neni 2- Ngarkesa dhe llogaritja e saj]. Për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike angazhohen 9 lektorë si staf akademik për 11 lëndë dhe përgatitja e temës së diplomes. Në total ky program studimi ka 788 orë dhe konsiderojmë që ngarkesa e stafit akademik për këtë program studimi nuk është e madhe dhe plotësisht e justifikuar. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

2. Të shikohet mundësia e ofrimit të mësimdhënies pjesërisht në gjuhën shqipe.

Universiteti “Epoka” synon të jetë një universitet i renditur në krye të klasifikimit. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike synon rritje të cilësisë së mësimdhënies dhe punësim të studentëve në fund të studimeve të tyre. Duke konsideruar që:

1. Dispozitat e Ligjit të Ri për Arsimin e Lartë të vitit 2015 dhe Udhëzimin e Ri të Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar për pranimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave është njohja e gjuhës së huaj angleze dhe dëshmia e mbrojtjes së saj;
2. Synimi i institucionit për punësim të studentëve në vend dhe në rajon;
3. Vazhdimi i studimeve të thelluara në universitete të huaja;
4. Ndërkombëtarizimi dhe rritja e bashkëpunimit me institucione dhe universitete në shtete të tjera që kanë sjellë edhe mobilitet të studentëve;

mendojmë se e bëjnë plotësisht të pranueshme ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike në gjuhën angleze. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

3. Të intensifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të pranuar, duke përdorur politika më efektive marketingu.

Nga shyrtimi i RVB, dokumenacionin bashkangjitur dhe vizitës dy ditore në institucion evidentojmë që Univeristeti “Epoka” ka të institucionalizuar kushtet e pranimit të studentëve për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri kompjuterike. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ndjek kritere të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e studentëve në këtë program studimi. Për programin e studimit organizohen edhe informime tek studentët në lidhje me mundësitë e thellimit të njohurive në këtë fushë. Ashtu siç e kemi argumentuar në vlerësimin tonë, seksioni 7, rekomandojmë që rritja e numrit të studentëve mund të rritet edhe përmes përmirësimit të përmbajtjes së kurrikules duke i dhënë një përkufizim më të qartë studentit që diplomohet në “Inxhinieri Kompjuterike”. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

4. Numri i përgjithshëm i disiplinave, të jetë më i kufizuar dhe i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentët të jenë më komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.

Numri i lëndëve që trajtohen në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është 11 dhe përgatitja e tezës së diplomës. Ky program ofron 1 lëndë nga disiplina (A), 5 lëndë nga disiplina (B), 2 lëndë nga disiplina (C), 1 lëndë nga disiplina (D), 1 lëndë nga disiplina (E) dhe teza e diplomës nga disiplina (F). Në total ofron 120 ECTS në dy vite akademike. Mendojmë se numri i lëndëve është i mjaftueshëm për një thellim të njohurive në këtë program studimi. Ky program ka fleksibilitet në përzgjedhjen e lëndëve me karakter bazë dhe të ngjashëm në 5 fusha kryesore . Fleksibiliteti bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga studentët dhe në përshatje me punësimin e tyre. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

5. Puna individuale duhet të stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve të ndryshme.

Në programin e studimit ofrohen forma të ndryshme të vleresimit dhe angazhimit të studentit gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Leksionet, orët në laborator janë bazë dhe frekuentimi i tyre është i detyrueshëm përkatësisht në masën 60% dhe 80%. Syllabuset e çdo lëndë janë të ndryshëm në funksion të përmbajtjes së lëndës. Organizohet punime individuale dhe projekte në grup. Mbrojtja e tyre bëhet përpara një komisioni të posacëm. Vizita në institucion dhe takimi me studentët konfirmoi punën efektive individuale që stafi akademik bën me studentët në këtë program studimi. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

6. Rekomandohet që të dhënat e përfituara nga KVAPC të analizohen dhe të bëhen pjesë më e drejtpërdrejtë e menaxhimit akademik dhe administrativ të IAL.

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike bashkëvepron me KVAZHC dhe bën përmirësimet e duhura në përshtatje me rekomandimet e bëra nga KVAZHC. Politikat e përmirësimit të kurrikulës bazohet në rekomandimet dhe analizat periodike të përgatitura nga KVAZHC. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

7. Një profilizim më i qartë i stafit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies.

Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi është i kualifikuar dhe njohës i mirë i gjuhës angleze. Ai mbart eksperiencë në fushën e inxhinierisë kompjuterike. Në raportin tonë kemi rekomanduar që Institucioni duhet të bëjë përpjekje të punësimit të një stafi të ri me eksperiencë në fusha të reja në përputhje me përmirësimet e kërkuara në kurrikul. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

8. Të vazhdohet puna e nisur me për bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke institucionalizuar ato me marrëveshjeve të qëndrueshme edhe në trojet shqiptare

RVB, dokumentacioni bashkëpunim dhe takime me grupe të ndryshme të interesit sjellin shembuj të një bashkëpunimi të gjerë me komunitetin e biznesit, me univeristete të huaja në kuadër të projekteve kërkimore shkencore dhe me institucione shtetërore në kuadër të marrëveshjeve institucionale. Tashmë departamenti i inxhinierisë kompjuterike ka 26 marrëveshje bashkëpunimi me kompani të mëdha të biznesit në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe bashkëpunon me universitete në Itali, Gjermani, etj. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

9. Të rritet bashkëpunimi me ndërmarrjet prodhuese lider në drejtimet përkatëse si Brenda vendit ashtu edhe në rajon.

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike bashkëpunon me 26 kompanite të biznesit. Bashkëpunimi konsiston në zhvillimin e praktikave profesionale. Meqenese praktika profesionale në Master i Shkencave Inxhinieri Kompjuterike nuk ofrohet, ky bashkëpunim konsiston në mundësinë e punësimit të studentëve në këto kompani në fund të studimeve të tyre. Bashkëpunim në rajon behen në kuader të projekteve. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur**

10. Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor dhe të zgjerohet pjesëmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare.

Universiteti "Epoka" ndjek politika të qarta në lidhje me kërkimin shkencor. Statuti i Universitetit ligjëron mekanizmat dhe të drejtat e stafit akademik për kërkimin shkencor. Kërkimi shkencor është në objektivat e institucionit. Strategjia e zhvillimit 2013 – 2017 dhe strategjia e zhvillimit të departamentit të inxhinierisë kompjuterike fokusohen edhe në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe integritit të studentëve në to. Universiteti "Epoka" ka ngritur në vitin 2013 Zyren e Projekteve dhe Hulumtimit e cila bashkëvepron punën e saj me Rektoren e Universitetit dhe njësitë bazë dhe qendrat kërkimore shkencore të ngritura në to. Takimi me stafin akademik dhe përfaqësues të kësaj zyre sollën shembuj të përdorimit të nxitësve nga ana e universitetit për rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në kërkim – shkencor. Neni 104 në Statutin e Universitetit ligjëron lirinë në fushën kërkimore – shkencore për stafin akademik si edhe shërbim ndaj palës së tretë por këto të jenë të integruara me mësimdhënien dhe të shërbejnë në rritjen dhe përmirësimin e saj. Dokumentacioni bashkangjitur RVB-së, vizita në institucion tregojnë për projekte në shërbim të universitetit dhe të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

11. Literatura shkencore vendase dhe e huaj në bibliotekë është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.

Universiteti "Epoka" ka të shprehur në strategjinë e tij 2013-2017 edhe synimin për pasurimin e bibliotekës. Biblioteka zotëron 5100 libra për të gjithë institucionin. Biblioteka ka 14 couches, 6 tavolina për 48 studente, dhe 9 tavolina për kompjuter. Në 33 raftë janë të vendosur librat sipas sistemit PC. Regjistrimi në bibliotekë, huamarrja e materialeve dhe katalogimi menaxhohen përmes sistemit të Menaxhimit të Bibliotekës Innopac. Anëtarësia është përfshirë edhe në të njëjtin server. Anëtarët mund të aksesojnë në internet përmes kartave të tyre të anëtarësimit, të dhënave të tyre, për materialet dhe periudhën e huamarrjes. Për menaxhimin e këtyre shërbimeve, është i dedikuar një server Unix i veçantë. Klientët mund të hyjnë në katalog përmes Java dhe mund të hyjnë edhe jashtë kampusit të universitetit [**vizite në terren, strategjia e institucionit 2013-2017, fq 28**]. Studentet e universitetit "Epoka" kanë akses të drejtpërdrejtë për të gjitha botimet dhe publikimet e bëra në konferenca dhe seminare të organizuara nga Institucioni. Ata kanë të drejtë akses edhe për temat e diplomave në nivelin Master. [**vizite në terren, strategjia e institucionit 2013-2017, fq 28**] Universiteti "EPOKA" është anëtar me të drejta të plota në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët dixhitale e krijuar në vitin 1995 që përmban më shumë se 2,000 revista akademike [**takim me pergjegjesin e bibliotekes**]

Për pasurimin e bibliotekës ndiqet një procedurë e qartë që buron nga njësitë bazë deri në vendimarrjen përkatese nga Rektori. Pasurimi me libra të rinj bëhet një herë në vit. Gjatë dy viteve të fundit akademike janë blerë 21 libra vetëm për inxhinierinë kompjuterike dhe elektronike [**dok shtese të marre në vizite: Lista e librave gjatë dy viteve të fundit akademike**].GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.

12. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimit duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Bazuar në dispozitat e Ligjit të Ri për Arsimin e Lartë të vitit 2015 dhe Udhëzimin e Ri të Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve Nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar studentit i kërkohet një certifikatë të gjuhës angleze të nivelit B2 në fillim të studimeve Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike. **GVJ konkludon që ky rekomandim është përmbushur.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti Epoka ka një mision të përcaktuar qartë dhe qëllime ambicioze dhe është një nga universitetet e pozicionuar shumë mirë në renditje në Shqipëri. Gjithashtu, vlen të përmendet angazhimi i universitetit për të qenë universiteti kryesor në Shqipëri. Nga kjo vizitë dhe nga raporti i vënë në dispozicion si pjesë e dokumenteve për këtë vlerësim, konfirmoj që Universiteti Epoka ka struktura dhe procese të menaxhimit të definuara qartë dhe një infrastrukturë shumë të mirë administrative dhe mësimdhënieje / kërkimore.

Misioni i Universitetit “Epoka” është i ndërtuar dhe i shprehur qartë në nenin 3 të Statutit të këtij Institucioni. Universiteti “Epoka” në të gjitha aktivitetet e tij ka si mision të jetë institucion arsimor dhe kërkimor novator dhe me ndikim, duke i shërbyer vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit dhe përhapjes së njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësinë e jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Në këtë kontekst, Universiteti Epoka synon të përgatisë individë të kualifikuar, produktivë dhe të aftë, të orientuar drejt kërkimit, me etikë profesionale dhe të ndjeshme ndaj shoqërisë, të hapura për sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për të materializuar këtë mision strategjik, programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është në përputhje me këto qëllime kryesore:

- Të përgatisë specialistë të lartë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat në ndryshim dhe zhvillimin e shoqërisë në fushën e inxhinierisë kompjuterike përmes mësimëve universitare-shkencore, të nivelit të avancuar dhe bashkëkohor teorik, metodik dhe praktik;
- Të ofrojë studime të thella akademike dhe të kryejë kërkime në fushën e inxhinierisë kompjuterike;
- Të kryejë kualifikime të larta të specialistëve në fushën e inxhinierisë kompjuterike;
- Për të tërhequr ekspertët më të mirë dhe për të inkurajuar me të gjitha mjetet kontributin e vazhdueshëm në fushat e tyre përkatëse;

- Të ofrojë kualifikim të vazhdueshëm dhe bashkëkohor për stafin akademik në fushat e tyre përkatëse, programet e studimit të arsimit të vazhdueshëm, thellimin dhe konsolidimin e njohurive të studentit, në formën e programit të kualifikimit dhe rikualifikimit, shkollat verore etj;
- Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të kontribuojë në ngritjen e standardeve demokratike dhe mirëqenien e shoqërisë dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë, i përbërë nga Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; Ky program zhvillohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike në bashkëpunim me Departamentet e tjera mësimore të Universitetit.

Misioni i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike është:

- Të edukojë studentët për të kuptuar bazat e shkencës dhe të inxhinierisë në mënyrë që ata të mund të zhvillojnë zgjidhje për problemet e Inxhinierisë Kompjuterike dhe të rrisin aftësitë e tyre në fushën e shkencave kompjuterike, arkitekturën kompjuterike, dizajnimin dhe analizën e algoritmave dhe aftësitë kërkimore.
- Ky departament synon veçanërisht të theksojë punën në grup, cilësinë e të menduarit dhe të lidhshirë të pavarur dhe inovativ.
- Qasja është të ofrojë një arsim të nivelit të lartë duke pasur lektorë me përvojë që ofrojnë klasa që përputhen me kurrikulat më të mira në botë.
- Në fokus të punës është zbatimi i teorisë në praktikë përmes ofrimit të laboratorëve moderne.

[Plani Strategjik 2017 – 2020 për Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, fq 1;]

Vizioni: Vizioni i kësaj kurrikule është që të jetë një departament i të diplomuarve të cilët janë shumë të preferuar në industrinë IT në mbarë botën dhe për të fituar një pozicion udhëheqës në Shqipëri dhe Ballkan. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka të shprehur qartë objektivat e tij afatgjatë në përputhje me objektivat e vetë Institucionit. Në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike evidentojmë objektivat si më poshtë vijon:

Misioni i programit Master në Inxhinieri Kompjuterike është:

Të pajisë studentët e diplomuar me njohuri të thella dhe aftësi për kërkimin shkencor në fushën e inxhinierisë kompjuterike, elektronikë etj. **[Rregullore e Ciklit të Dytë të studimeve , neni 5]**

Objektivat e programit të studimit MSc në Inxhinieri Kompjuterike janë:

- Njohuri të mjaftueshme të parimeve inxhinierike për të kuptuar bazat dhe aplikimin e analizave standarde, projektimit dhe praktikave të zbatimit brenda fushës së tyre.

- Aftësinë për të bërë analiza inxhinierike dhe për të zhvilluar dhe zbatuar projekte dhe zgjidhje në lidhje me problemet e projektimit, që plotësojnë kushtet e kodeve dhe standardeve të praktikës.
- Njohuri bazë të faktorëve të ndryshëm teknikë dhe joteknikë që ndikojnë në fisibilitetin dhe zbatimin e projekteve të inxhinierisë kompjuterike, përfshirë: fisibilitetin teknik, përfshirjen e shumë palëve, vlerësimin mjedisor, planifikimin financiar dhe ekonomik, administrimin pronar/punë publike, planet strategjike të pronarit dhe çështjet socioekonomike/të paanshmërisë. Bazat e nevojshme për të zhvilluar gjykimin inxhinierik përmes praktikës profesionale, si edhe për të identifikuar, konsideruar dhe peshuar me efektivitet objektivat e shumëfishtë dhe konkurrues.
- Njohuritë teknike dhe aftësitë e nevojshme për të ndjekur procesin e të nxënimit gjatë gjithë jetës, me aftësinë për të zhvilluar në mënyrë të pavarur njohuritë dhe të kuptuarit e temave dhe praktikave inxhinierike me anë të kërkimit të literaturës, konsultimit me të tjerët dhe përdorimit të teknikave të tjera të ngjashme.
- Njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kaluar provimet e licencës në fushën e tyre të specialitetit.


Përmbushja e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike janë edhe në përputhje me fushat më prioritare të përcaktuara edhe në Strategjinë e Zhvillimit për Inxhinierinë Kompjuterike si më poshtë vijon:

- Të sigurojë një mjedis të cilësisë së lartë për mësimdhënie.
 - Të rekrutjë, edukojë dhe diplomojë studentë të masterit shkencor me cilësi të lartë;
 - Të prodhojë rezultate që mund të zbatohen në nivel kombëtar;
 - Të sigurojë një mjedis të cilësisë së lartë për hulumtime shkencore;
- [Strategjia e Zhvillimit 2017-2020, fq 4-5];

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit "Epoka". Këtë e gjetëm të shprehur në Statutin e Universitetit, në Rregulloren e Universitetit për Studimet Master në të gjitha departamentet.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.




<p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Misionin e Universitetit “Epoka” e gjetëm të shprehur qartë në Statutin e Institucionit. Programi është i ndërtuar bazuar në objektivat e përgjithshme të Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierise Kompjuterike. Objektiva specifike janë të ndertuara qartë dhe në strategjine afatgjatë të Zhvillimit të Departamentit të Inxhinierise Kompjuterike, brenda të cilit zhvillohet edhe ky program. [Aneks 15:Rregullore e Ciklit të Dytë Të Studimeve, neni 3; Strategjia e Zhvillimit 2013-2017, 2017-2020, fq 1, fq 4-5];</p> <p>Programi është hartuar bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut. Në studimin e programit Master i Shkenacve ofrohen njohuri më të thelluara kërkesë kjo e ardhur nga tregu i punës dhe nga studentë të cilët kërkojnë të vazhdojnë studimet e tyre në nivelin Doktoraturë [takim me dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike].</p> <p>Bazuar edhe në rezultatet e pyetsorit për vitin 2017 rezulton se 85% e të diplomuarve janë të punësuar pas përfundimit të studimeve në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike [dok shtese –statistika mbi punesimin fq 1].</p> <p>Ky program është ndërtuar bazuar edhe në politikat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe në politikat e qarta të ndjekuara nga MASR e shprehur ne Statut dhe ne Rregulloren për këtë program studimi.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Inxhinieri Kompjuterike” është i ndërtuar mbi bazën e një Plani Strategjik të Zhvillimit të Universitetit 2013-2017, dhe Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit të Departamentit të Inxhinierise Kompjuterike 2017-2020 [Strategjia e Zhvillimit 2013-2017, 2017-2020, fq 1, fq 4-5];</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është i ndërtuar mbi bazën e një eksperience të gjerë të stafit akademik në këtë fushë, mbi bazën e kërkesave dhe nevojave në vazhdim të tregut të punës në Shqipëri dhe në Rajon, mbi bazën e</p>

	përmirësimeve të ardhur nga rekomandimet e dhëna nga akreditimi i parë. [takim me stafin akademik, takim me dekanin e fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinirisë Kompjuterike].
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është Akredituar me urdhër nr.286 datë 06.07.2012 të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Programi ofrohet në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe funksionin mbi bazën e Rregullores për Programet Master miratuar dhe në Senatin Akademik.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit është e ndërtuar mbi Ligjin e Arsimit të Lartë në fuqi dhe akteve ligjore dhe nënligjore të tij.</p> <p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është në përputhje me nivelin e shtatë të kualifikimeve, siç përcakton Korniza Shqiptare e Kualifikimit dhe është në linjë me Ligjin nr. 10247, dt. 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është i ndërtuar mbi bazën e një eksperience të gjerë të stafit akademik në këtë fushë, mbi bazën e kërkesave dhe nevojave në vazhdim të tregut të punës në Shqipëri dhe në rajon, mbi bazën e përmirësimeve të ardhur nga rekomandimet e dhëna nga akreditimi i parë [takim me stafin akademik, takim me dekanin e fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike].</p> <p>Përmirësimi i programit të studimit është në fokus të vazhdueshëm të institucionit. Programi i studimit gjendet i inkorporuar në Strategjinë e Zhvillimit 2013-2017 të Universitetit “Epoka” dhe në Strategjinë e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike 2017-2020.</p> <p>Universiteti “Epoka” ndjek një politikë të qartë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Rishikimi i program</p>

	<p>studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike administrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike, Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës nën Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senati Akademik [aneks18:Politika mbi përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit].</p> <p>Lidhur me këtë program Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e programit të studimit, orët në mësimdhënie nga stafi akademik, duke përfshirë reagimet nga studentët dhe palët e interesuara për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e programeve studimore [aneks 18: Politika mbi përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, Takim me studentet, takim me stafin akademik, takim me NJBSC]</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron programin e studimit Msc në “Inxhinieri Kompjuterike”. Programi synon aftësimin e studentëve në tregun e punës përmes përthithjes së njohurive të thelluara profesionale në këtë fushë.

Programi shpreh objektivat e vetë institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Inxhinierisë. Programi është ndërtuar mbi bazën e konsultimit të stafit akademik, konsultimeve me kompanitë e biznesit dhe përmes një studimi të qartë të tregut të punës.

Standardi I.1 mendojmë se përmbushet

Standardi I.2 mendojmë se përmbushet

Standardi I.3 mendojmë se përmbushet


Standardi I.11 mendojmë se përmbushet

GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit




Struktura organizative e Universitetit "Epoka" është sipas organigramës së paraqitur në RVB. Kjo organigramë është në përputhshmëri me organigramën që ndodhet në dokumentin "Statuti i Universitetit" dhe në faqen ueb me adresë "<http://epoka.edu.al/home-staff-organization-scheme-6-46.html>".

Në të paraqitet dhe struktura organizative e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave sipas secilës strukturë të paraqitura në RVB janë në përputhshmëri me detyrat dhe përgjegjësitë e përshkruara në statutin e Universitetit "Epoka", në Rregulloren e Universitetit për studimet Master. Organigrama e Universitetit "Epoka" dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave akademike të saj tregojnë se këto struktura janë në funksion të plotë të përmbushjes së misionit të tij: të jetë një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe ndikues, duke i shërbyer vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit dhe shpërndarjes së njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në bazë të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare rajonale. Autonomia dhe liria akademike e Universitetit sanksionohet në Statutin e Universitetit [**Statuti neni 4, neni 5**].


Organet drejtuese janë:

- a) Senati akademik;
- b) Rektori;
- c) Dekanantet;
- d) Drejtimet e njësive kryesore akademike;
- e) Këshilli i Etikës;
- f) Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Stafit Akademik;
- g) Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë;
- h) Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet e Studentëve;
- i) Komisioni i Përhershëm për dhënien e doktoratës;
- j) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- k) Bordi Administrativ.

Autoritetet drejtuese ekzekutive për këtë institucion janë:

- a) Rektori;
- b) Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike;
- c) Shefi i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike;
- d) Drejtori i qendrës kërkimore shkencore;
- e) Zëvendës-Rektori dhe Zëvendës-Dekani;
- f) Administratori i Universitetit;
- g) Administratori i njësisë kryesore.

- Rektori i Universitetit EPOKA propozohet nga Senati Akademik dhe emërohet me vendim të Bordit Administrativ në përputhje me dispozitat e këtij Statuti për një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje një herë.
- Dekani emërohet nga Rektori pas miratimit të Senatit Akademik për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë në këtë pozitë
- Udhëheqësi i njësisë bazë propozohet nga Dekani në radhët e anëtarëve të rregullt të stafit akademik dhe emërohet nga Rektori pas miratimit të Senatit Akademik për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje vetëm një herë.




Të drejtat dhe detyrat e organeve drejtuese dhe ekzekutive janë të shprehura qartë në Statutin e Universitetit dhe në Rregulloren e Studimeve për Nivelin Master.

[statuti i universitetit neni 45-55]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit



Universiteti "Epoka" ka në përbërje të tij tre fakultete:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë,
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet nga tre Departamente dhe për vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **58 personel akademik** konkretisht:

Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike përgjegjës për programin e studimit, ka gjithsej **20** pedagogë nga të cilët **12** janë personel akademik efektiv (PAE), kurse **8** pedagogë janë personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit ka gjithsej **20** pedagogë, nga të cilët **12** janë personel akademik efektiv (PAE) dhe **8** personel akademik me kontratë (PAK).

Departamenti i Arkitekturës ka gjithsej **18** pedagogë, nga të cilët **9** janë personel akademik efektiv (PAE) dhe **9** personel akademik me kontratë (PAK).

Mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" të treja fakultetet organizohen në njësi bazë të cilat sipas "Rregullores Themelore" të Universitetit Epoka janë Departamentet dhe Qendrat Kërkimore.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka tre departamente:

- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka tre departamente:

- Departamenti Financë – Bankë,
- Departamenti Ekonomiksit
- Departamenti Administrim Biznesit.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga dy departamente dhe një qendër kërkimore:

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Departamenti i Drejtësisë
- Qendra për Studime Europiane

Struktura përgjegjëse për programin “Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike” është Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

Të tre departamentet e këtij fakulteti kanë mision dhe objektiva të mirëpërcaktuara. Ato janë të publikuara në faqen ueb të secilit prej departamenteve <http://fae.epoka.edu.al/>.

Detyrat dhe përgjegjësitë që kanë Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike dhe drejtuesi i departamentit janë të përcaktuara në statutin e Universitetit “Epoka”. Nga vizita e bërë në Universitetin “Epoka” u konstatua se dekani i “Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike” si dhe drejtuesi i departamentit të “Inxhinierisë Kompjuterike” janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që u lindin për realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike”. Procesi i rekrutimit në universitetin “Epoka” është përshkruar në dokumentat “Procedura e rekrutimit të stafit të ri akademik” dhe “Rregullore Për Rekrutimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik”. Sipas këtyre dokumentave fakulteti dhe departamenti janë të përfshirë në rekrutimin e stafit të tij akademik. Vlerësimi i Performancës së stafit akademik është rregulluar me anë të “Rregullores “Për Rekrutimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik”. Gjithashtu në dokumentin “Politika e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit” përcaktohet mekanizimi i vlerësimit të kurseve dhe mësimdhënies. Sipas këtyre dokumentave fakulteti dhe departamenti janë të përfshirë në vlerësimin e stafit të tij akademik.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike zhvillohet në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, pranë departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike.

Gjatë vitit akademik 2017-2018 departamenti ka në përbërje gjithsej **20 personel akademik** nga ku **12 personel akademik efektiv (PAE)** dhe **8 personel akademik me kontrate (PAK)**.

Për këtë program studimi angazhohen për vitin akademik 2017-2018, 7 personel akademik efektiv, 5 personel administrativ dhe 1 staf akademik me kohë të pjesshme.

Numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me titullin **Profesor Doktor është 1(një)**, numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me titullin **Profesor i Asociuar është 1(një)** dhe numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me gradën **Doktor është 5(pesë)**.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Tabela 4: Emri i koordinatorit akademik te programit të studimit;

Tabela 5: Të dhëna per vitin akademik 2012 – 2013;

Informacion per stafin akademik per periudhen 2012-2013 deri ne 2016-2017;

Në aneks janë paraqitur tabelat që i referohen stafit akademik që është angazhuar në këtë program studimi për periudhën 2012-2013 deri në 2016-2017

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti "Epoka" është i organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij.</p> <p>Secili nga organet drejtuese akademike ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi. Çdo njësi ka detyrat dhe objektivat e veta. Njësia bazë organizon veprimtarinë mësimdhënëse dhe kërkimore, njësitë kryesore bashkërendojnë aktivitetet e njësive që përfaqësojnë. Njësitë administrative mbështesin me aktivitete të ndryshme.</p> <p>Universiteti "Epoka" përbëhet nga tre fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, 2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative; 3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale; <p>Të tre fakultetet organizohen në njësi bazë dhe secila prej tyre ka tre të tilla. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë të treja njësitë bazë i ka departamente konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Arkitekturës; • Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; • Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; <p>Struktura përgjegjëse për programin “Master i</p>

	<p>Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike” është Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë/departamenti i inxhinierisë kompjuterike. Të tre departamentet e këtij fakulteti kanë mision dhe objektiva të mirëpërcaktuara.</p> <p>Departamenti ka në përbërje të tij 12 anëtarë anëtarë efektivë si personel akademik. 7 prej anëtarëve të stafit akademik efektiv janë me tituj /grada.</p> <p>Numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me titullin Profesor Doktor është 1(një), numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me titullin Profesor i Asociuar është 1(një) dhe numri i anëtarëve të stafit akademik efektiv me gradën Doktor është 5(pesë).</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë që kanë Dekani dhe drejtuesi i departamentit janë të përcaktuara në statutin e Universitetit “Epoka”. Sipas dokumentave të siguruar nga RVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion GVJ konstaton se dekani i “Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike” dhe drejtuesi i departamentit “Inxhinieri Kompjuterike” janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që u lindin për realizimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike”.</p> <p>Sipas dokumentave të siguruar nga RVB dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion GVJ konstaton se departamenti i “Inxhinierisë Kompjuterike” dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përfshihen në procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit akademik. Procesi i rekrutimit në universitetin “Epoka” është përshkruar në dokumentat “Procedura e rekrutimit të stafit të ri akademik” dhe “Rregullore Për Rekrutimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik”. Sipas këtyre dokumentave fakulteti e departamenti janë të përfshirë në rekrutimin e stafit të tij akademik. Vlerësimi i performancës së stafit akademik është rregulluar me anë të “Rregullores Për Rekrutimin dhe Vlerësimin e Performancës së Stafit Akademik”. Gjithashtu në dokumentin</p>

	<p>“Politika e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit” përcaktohet mekanizimi i vlerësimit të kurseve dhe mësimdhënies. Sipas këtyre dokumentave fakulteti dhe departamenti janë të përfshirë në vlerësimin e stafit të tij akademik.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti “Epoka” organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij. 2. Misioni dhe Objektivat e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike janë të mirëpërcaktuara. 3. Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. 4. Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve. <p>Standardi II.2 mendojmë se përmbushet;</p> <p>Standardi II.3 mendojmë se përmbushet;</p> <p>GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.


Në bazë të Statutit të Universitetit “Epoka”, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi Msc. në “Inxhinieri Kompjuterike” zhvillohet në këtë departament. Për realizimin e këtij programi angazhohet stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike drejtohet nga një personel i kategorive të mëposhtme [**Statuti i Universitetit, neni 45-55**]:

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme;
2. Personeli ndihmës-akademik;
3. Personeli administrativ;

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës, në Rregulloren e Universitetit për nivelin Master dhe në rregulloren e Fakultetit [**Statuti i Universitetit “Epoka” neni 45-55, Rregullore e Universitetit për Nivelin Master**].

Aktualisht janë të angazhuar për programin Msc në “Inxhinieri Kompjuterike” stafi i mëposhtëm:

- Personeli Akademik




Gjatë vitit akademik 2017– 2018 në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike janë angazhuar në mësimdhënie **7 PAE** dhe **1 PAK**.

Personeli ndihmës – akademik për Departamentin e Inxhinierisë:

a. 2 asistentë departamenti

Personeli administrative

- Koordinatorë Departamenti [vizitë në terren]
- Përgjegjës për Laboratorët [vizitë në terren]
- Koordinator në Zyrën e Regjistrimit [vizitë në terren]
- Specialiste në Zyrën e Regjistrimit [vizitë në terren]
- Specialiste në Zyrën e Regjistrimit [vizitë në terren]
- **Zyra e IT qe ka:**
 - 1 Përgjegjës IT [vizitë në terren]
 - 2 Specialistë IT [vizitë në terren]

Raporti PAE/PAK

Raporti PAE/PAK në këtë program është 7/1

Raporti Personel akademi/Personel administrativ është 8/5=1.6

Raporti Personel akademik/Studentë është 8/26 = 0.30

Raporti Personel administrativ/Studentë është 5/26=0.19

Institucioni ndjek rregulla të qarta dhe të sanksionuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në rregulloren e burimeve njerëzore për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe të stafit administrativ. Procedura e rekrutimit të stafit është e qartë dhe u evidentua si gjatë RVB dhe dokumentacionit mbështetës ashtu edhe gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore [**aneks 35: procedura e rekrutimit të stafit akademik, vizitë në zyrën e burimeve njerëzore**]. Për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe atij administrativ ndiqen edhe fazat e mëposhtme:

Faza 1:

- Hartimi i nevojave të personelit nga Departamenti-Fakulteti-Rektorati. Kriteret specifike për konkurim përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë [**takim me stafin akademik, takim me shefin e departamentit të Inxhinierise Kompjuterike**]
- Përgatitja e Lajmërimeve të Vendeve të Punës nga HRO
- Publikimi në rrjetin e njoftimeve nga HRO

Faza 2: Kandidatët e kualifikuar duhet të dorëzojnë një skedar online ose hardcopy që përmban:

- Informacionin dhe forma e aplikimit të stafit akademik të Universitetit Epoka
- Diplomat
- CV
- Versioni i plotë i artikujve të botuar, gazetave etj.
- Certifikata dhe kualifikime të tjera
- HRO qe kalon dosjen e dorëzuar në fakultetin përkatës;

Faza 3-Aplikimet vlerësohen paraprakisht nga një juri e përbërë nga tre anëtarë të zgjedhur nga Bordi Administrativ i Fakultetit.

- Juria vlerëson përshtatshmërinë e kandidaturave në vendin e lirë
- Bordi Administrativ i Fakultetit i cili ben vlerësimin e kandidaturave;
- Marrja e vendimit nga Bordi Administrativ i Fakultetit

Faza 4: Vendimi i Bordit Administrativ të Universitetit

- Propozim me shkrim në Bordin e Lartë të Universitetit
- Aprovimi përfundimtar i Bordit të Lartë të Universitetit

Faza 5: Kandidati dorezon dokumentet e lartepërmendura në Formularin e Informacionit të Stafit dhe nënshkruan kontratën e punës. Plotëson informacionin e stafit në SIS dhe ben hapjen e emailit nga zyra e IT.

- HRO përgatit letrën e detyrës e cila nënshkruhet nga Rektori.
- HRO informon të gjithë stafin përmes e-mailit mbi stafin e perzgjedhur te ri.

Synohet të përthithet stafi akademik me eksperiencë dhe gradë shkencore te larte.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)**

Evidentojmë duke parë ecurinë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi që gjatë periudhës 2012-2018 departamenti i inxhinierisë kompjuterike ka mbuluar programin e studimit me staf akademik me kohë të plote (mbi 70% e ngarkesës mbulohe nga stafi akademik). Në këtë ecuri evidentojmë punën që behet për punësimin e një stafi akademik(PAE ose PAK) me grada shkencore.

Viti akademik	PAE	PAK	% e stafit PAE të angazhuar
2017-2018	7	1	87.5%
2016-2017	6	3	66.7%
2015-2016	6	4	60%
2014-2015	4	3	57.14%
2013-2014	5	2	71%
2012-2013	6	2	75%

Tabela 2 – jepet ne aneks

Në lidhje me ngarkesën mësimore të stafit akademik për vitin 2017 – 2018 kemi:

Emer mbiemër	Orët për pedagog / 800 orë total	Përqindja
Elton Domnori	160 ore	20%
Julian Hoxha	240 orë	30%
Betim Çiço	160 ore	20%

Arban Uka	160 orë	20%
Ito Eëasito	80 orë	10%

☑ Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit (sipas RVB)

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Arban Uka	Prof.Asoc.	Kryetar/Koordinator Akademik
Ali Osman Topal	Dr.	Anëtar
Julian Hoxha	Dr.	Anëtar

Këshilli Shkencor i Programit të Studimit ka një anëtarësi prej tre vetash. Në takimin me shefin e departamentit të inxhinierisë kompjuterike u theksua synimi në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor nga stafi akademik dhe rritja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore shkencore. Institucioni ndjek një politike të qartë në lidhje me matjen e performancës akademike të stafit dhe përdor instrumenta nxitës si shpërblime, për ata që dallohen në publikime në revista shkencore me faktor të lartë impakti, ose janë pjesë e projekteve kërkimore. **Në aneks jepet Tabela 3;**

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Duke shqyrtuar tabelat në lidhje me gradat e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për periudhën 2012-2018 evidentojmë që institucioni bën një punë të madhe në lidhje me punësimin e stafit akademik me grada të larta shkencore. Kjo tendencë është në rritje.

Për vitin akademik 2014 – 2015, 2015-2016 kemi pjesëmarrjen e stafit me gradë BSc përkatësisht 8 dhe 7 për këto dy vite në departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike. Kjo shpjegohet me politikën e re të institucionit që filloi të angazhojë studentët më të mirë të jenerësive të këtyre viteve në këtë program. Institucioni ndjek politikë të qartë për përthithjen e një stafi PAK me eksperiencë. Gradat shkencore për këtë staf janë minimalisht Dr. Numri i stafit akademik PAK në vite ka filluar të reduktohet duke forcuar edhe një herë politikën e institucionit për të mbuluar ngarkesën me staf akademik me eksperiencë dhe me kohë të plotë.

Tabela e Stafit akademik (PAE)

Viti akademik	MSc.	Dr.	Prof.Asoc.	Prof.Dr.
2012-2013	5	3	1	-
2013-2014	5	2	-	-
2014-2015	8	3	-	-
2015-2016	8	3	-	-
2017-2018	-	5	1	1

Tabela e Stafit akademik (PAK)

Viti akademik	MSc.	Dr.	Prof.Asoc.	Prof.Dr.
2012-2013	1	1	-	1
2013-2014	1		-	2
2014-2015	3	3	1	1
2015-2016	3	3	1	1
2017-2018	-	-	1	-

Të dhënat sipas seksit

Nuk kemi të dhëna në lidhje sipas gjinisë por theksojmë që institucioni motivon pjesëmarrjen e gjinisë femërore në rolet vendimarrëse dhe në stafin akademik.

Të dhëna sipas moshës së personelit (

Bazuar edhe në të dhënat e paraqitura nga institucioni në lidhje me stafin akademik sipas grup-moshave evidentojmë angazhimin e stafit akademik në grup-moshën 25-35 vjeç në një përqindje 54%, vijojne stafi akademik me grup moshë 36-45 vjeç në përqindje 18%, grup – mosha 46-55 vjeç në përqindje 18% dhe 10% i përkasin stafit akademik me grup-moshë 65-68 vjeç. Këto të dhëna i përkasin vitit akademik 2017-2018, por duke bërë një analizë të tendencës në vite (2012-2018) vëmë re që institucioni në vite ka tentuar të angazhojë staf të ri në moshë dhe me kohë të plotë. Kjo thekson politikën në tërësi institucionale të universitetit për aktivizim të stafit me kontrata afatgjata duke investuar në zhvillimin akademik të tyre dhe duke siguruar një qëndrueshmëri në aspektin e mësimdhënies përmes sigurimit të një stafi në terma afatgjata kontraktuale. Vlen të theksohet edhe angazhimi i një stafi administrativ në moshë të re (100% në grup moshën 25-35 vjeç). Tabelat sipas grup moshës jepen në aneks.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Institucioni ka dorëzuar një kopje të kontratës së punës për staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Gjatë vizitës në drejtorinë e burimeve njerëzore verifikuam edhe kopje të kontratës për staf akademik me shtetësi të huaj, shqiptar me kohë të plote dhe me kohë të pjesshme. Kontratat janë me afat për staf akademik me kohë të pjesshme ndërsa për stafin akademik me kohë të plotë janë me afat të pacaktuar. Kontratat janë të ndertuar mbi Kodin e Punës në Shqipëri dhe japin qartë detyrat dhe përgjegjësitë e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Në kontratë jepet edhe ngarkesa mësimore.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Cilësia e stafit akademik ndihmës është e lartë. Në stafin akademik ndihmës rol luajne edhe studentët me rezultate te larta në nivelin Bachelor. Për vitin akademik 2017-2018 janë anagzhuar 5 veta si personel ndihmës por në mbështetje të mësimdhënies janë edhe struktura të tjera ndihmëse ku roli dhe përgjegjësitë e tyre janë të dhëna qartë ne Statut dhe ne Rregulloret përkatëse në nivel universiteti dhe departamenti.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion


- Tabela për stafin akademik për vitet akademike 2012 - 2017

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Institucioni ndjek rregulla të qarta dhe të sanksionuara në Rregulloren e Fakultetit të Arkitektures dhe Inxhinierise Kompjuterike për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe stafit administrativ [aneksi 38- procedura per rekrutim te stafit akademik, vizite ne zyren e burimeve njerezore]. Përzgjedhja e personelit akademik dhe ndihmës mësimor – shkencor bëhet në përputhje me nevojat e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Kriteret e pranimit hartohen në departament dhe përzgjidhet kandidati më i mirë që kalon në pesë fazat e rekrutimit. Anëtarët e komisionit <i>ad hoc</i> duhet të kenë minimalisht gradën Dr. Për përzgjedhjen e personelit ndihmës akademik përdoret e njëjta procedure rekrutimi. Tashmë për programin Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike janë në dispozicion staf ndihmës – akademik me gradën Msc dhe Bsc. Këta të fundit janë studentët më të mirë të cilët angazhohen për të ofruar asistencë në laboratorë.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Njësia bazë për përmirësimin e kurrikulës është departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës ndiqet një procedurë e qartë dhe e sanksionuar edhe në Senat [aneksi 36: politikat për përmirësimin e programit mësimor]. Arsyeet e përmirësimit të programit mesimor janë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimet dhe misionit të institucionit; • Standardet Kombëtare të Akreditimit (Standardet e Cilësisë Shtetërore / Kodi i Cilësisë); • Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë • (ESG) (si pikë referimi e jashtme); • Korniza Kombëtare e Kualifikimeve; • Rritja e nevojës për teknologji ose aftësi të reja që duhet të mësohen ose kompetencat;

	<ul style="list-style-type: none"> • Nevojat e tregut të punës dhe nevojat e studentëve; • Përgjigjet e pranuar nga Studentët e tanishëm; • Feedback marrë nga Alumni. <p>Të gjitha propozimet për të bërë ndryshime në kurrikulën ekzistuese paraqiten në bazë të formularit të Propozimit të Kurrikulumit dhe në përputhje me procesin e përshkruar më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i kerkuar propozohet nga pedagogët e departamentit të inxhinierisë kompjuterike dhe i dërgohet Dekanatit të Fakultetit. • Nëse Dekanati rekomandon përmirësimin, ndryshimi i propozuar dorezohet në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulës. • Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulës do të japë mendimin për ndonjë ndryshim apo sugjerim. Më pas procesverbali do t'i dërgohet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. • Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë do të shqyrtojë kurrikulën e propozuar me të dhëna nga Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulumit dhe e dërgon propozimin për ndryshimi i kurrikulës në Senatin Akademik për miratim përfundimtar. <p>Rekrutimi i stafit të ri akademik bëhet sipas një procedure të qartë rekrutimi. Ngarkesa për stafin e ri akademik është e përcaktuar qartë në rregulloren për përcaktimin e ngarkesës [aneks 18 shtese-ngarkesa për stafin akademik për vitin 2017-2018, aneks 11 – direktivat për përcaktimin e ngarkesës mesimore].</p> <p>Ngarkesa mesimore e anëtarëve të stafit akademik në Universitetin Epoka kryhet në përputhje me kontratat e tyre të punës. Në rastet kur ngarkesa mesimore nuk është përcaktuar me kontratën përkatëse, ngarkesa mesimore në javë sipas detyrave akademike dhe administrative është si më poshtë:</p> <p>Rektori 6 (gjashtë), Nënkryetari 9 (nëntë), Dekani 9 (nëntë), Shef i Departamentit 12 (dymbëdhjetë), Prof. Dr. 16 (gjashtëmbëdhjetë), Assoc.Prof. Dr 16 (gjashtëmbëdhjetë), Dr 16 (gjashtëmbëdhjetë), Asistent Ligjërues 20 (njëzet).</p> <p>Llogaritja e ngarkesës mesimore bëhet: 1 ore teori = 1 ore ngarkesë 1 ore praktike = 1 ore ngarkesë</p>

	1 ore keshillim ne klase = 1 ore ngarkesë
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik kryhet sipas nje procedure te qarte. Rekrutimi i personelit akademik kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe personelit akademik burojnë nga kontratat e punës. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore u shqyrtuan edhe kontrata për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.</p> <p>Kontrata për stafin akademik me kohë të plotë është pa afat, ndërsa për stafin akademik me kohë të pjesshme është me afat semestral. Në lidhje me rekrutimin e stafit të huaj Universiteti “Epoka” ndjek një politike favorizuese. Afati i kontrates për staf akademik të huaj për herë të parë është 1 vjecar. Politika favorizuese bëhet në pagesën për stafin e huaj [vizitë në departamentin e burimeve njerëzore].</p> <p>Përmbajtja e kontratës është në përputhje me Legjislacionin Shqiptar për punën dhe me Ligjin Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Universiteti "EPOKA" në Dhjetor 2014 ka miratuar edhe Kartën Evropiane për Kërkuesit Shkencorë dhe Kodin e Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve Shkencorë. KE e pranoi kërkesën dhe "EPOKA" tashmë renditet mes institucioneve që e kanë miratuar deklaratën.</p> <p>Gjate vizites u verifikua dokumentacioni për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme [dokumentacioni për Prof. Ēasito me origjinë nga Indonesia dhe Dr. Elton Domnori nga Shqipëria].</p> <p>Për vitin aktual 2017 – 2018 për mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike angazhohen si personel akademik efektiv (PAE) 7 pedagoge dhe 1 pedagogë me kohë të pjesshme (PAK).</p> <p>Pra mbi 87.5% e stafit akademik efektiv jane te angazhuar në këtë program studimi. Institucioni angazhon të gjithë hallkat për vlerësimin e programit të studimit. Një nga arsyet e procesit të permirësimit të vazhdueshëm është marrja e</p>




	<p>feedback-ut nga studentët dhe alumni. Të dhënat për vlerësimin e stafit akademik bëhen nga zyra e NJSBC e cila cdo semester ndërmerr edhe pyetorë për vlerësimin e lëndëve në këtë program studimi. Zyra e burimeve njerëzore dhe zyra e financës shërbejnë për mbajtjen e të dhënave dhe dosjeve për personelin akademik, ndihmës dhe administrativ. Zyra e financës mban kontratat e punës ndërsa zyra e burimeve njerëzore mban dhe është përgjegjëse për procedurën e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës dhe për arshivën e të dhënave për çdo individ i angazhuar në këtë program [vizite ne zyren e burimeve njerezore]</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit është njëkohësisht edhe përgjegjës i programit. Ai mban titullin “.Prof As. Dr.”.</p> <p>Gradën shkencore “Doktor” e ka marrë në Universitetin e Teksasit në Austin, SHBA, dhe ka punuar për tre vjet në Universitetin e Leidenit, Holandë.</p> <p>Secila lëndë jepet nga pedagog që mban titullin/gradën “Doktor” ose “Prof.Asoc.Dr”.</p> <p>Disa lëndë mbikëqyren nga grupi i pedagogëve, nga të cilët, të paktën njëri ka gradën “Doktor”.</p> <p>Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar si personel akademik me kohë të plotë.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Cdo student ne progamin Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike duhet të përgatisë një tezë për marrjen e diplomës. Temat e tezave janë bashkëkohore [aneksi 2 – temat e tezave te mbrojtura].</p> <p>Cdo student ka një udhëheqës. E drejta buron në Rregulloren e Fakultetit te Arkitektures dhe Inxhinierise Kompjuterike dhe ne Rregulloren e Studimit për Nivelin Master. Nga takimi me studentët evidentuam një punë aktive që bëjnë udhëheqësit për përgatitjen e temës së diplomës. Konsultime kryhen për fazën kërkimore dhe për fazën e shkrimit të tezës.</p> <p>Te gjithë udhëheqësit kanë gradën Prof.Asoc ose Dr.</p> <p>Aktualisht, një udhëheqës mbikëqyr 1 deri 3 studentë. Udhëheqësi nuk udhëheq më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht. Për momentin, kemi 6 studentë Masteri në fazën e shkrimit të tezës. Numri i udhëheqësve është 7.</p> <p>Numri i pakët i studentëve bën që të arrihet një punë më cilësore në lidhje me përgatitjen e studentëve.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Cdo student në Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike duhet të përgatisë një teze për marrjen e diplomës. Temat e tezave janë bashkëkohore [aneksi 2 – temat e tezave te mbrojtura].</p> <p>Temat e tezave janë në përputhje me fushat ku pedagogët publikojnë rregullisht ose janë të përfshirë në projekte kërkimore shkencore. Shembull u sollën në takimin me studentët. Përzgjedhja e udhëheqësit bëhet në përputhje me temën e diplomës e cila kryesisht përzgjidhet sipas nevojave dhe kërkesave të tregut të punës dhe në përputhje me specializimet që ka vetë udhëheqësi.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Institucioni angazhon personelin ndihmës akademik për mbarëvajtjen e tre laboratorëve në këtë departament. Departamenti angazhon edhe studentë të mirë të përfshihen në këtë proces. Në njërin nga laboratorët departamenti kishte vendosur përgjegjës student tashmë i diplomuar dhe tepër</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>aktiv në këtë fushë. Laboratorët janë në shërbim të studentëve gjatë gjithë ditës. Nëse studentët kanë nevojë të punojnë jashtë orarit përmes një miratimi paraprak nga departamenti vihet në dispozicion të tyre edhe në orët e mbasdites. Laboratorët janë të pajisur me të gjithë mjetet për të konkretizuar orën praktike dhe teorike .</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa e personelit është e përcaktuar sipas direktivave të qarta të miratuara në Senatën Akademik të Universitetit.</p> <p>Nga dokumentacioni për ngarkesën mësimore për vitin akademik 2017 – 2018 nuk evidentojmë një mbingarkesë të madhe të stafit akademik. Institucioni ndjek politika të qarta për pagesën e orëve mbi ngarkesë.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni ka një bazë të dhënash të detajuar për personelin akademik të përfshirë në program; Te dhenat mbahen në departament për arritjen shkencore dhe shërbejnë për vlerësimin e performances së stafit akademik;</p> <p>Te dhena të personalizuar mbahen në zyrën e burimeve njerëzore së bashku me praktiken e rekrutimit të stafit akademik (me kohe të plote dhe të pjesshme) dhe stafit administrativ; Kontratat mbahen në zyrën e financës;</p> <p>Procedura e rekrutimit të stafit është transparente dhe publikohet edhe në vetë faqen zyrtare të universitetit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Grupi i vlerësimit bazuar në RVB, takimin me përgjegjësën e departamentit të inxhinierisë, stafin akademik, vizitën në sekretarinë mësimore dhe në zyrën e Burimeve Njerëzore, konstaton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procesi i rekrutimit është i qartë, i drejtë dhe transparent. • Kërkesa për rekrutim buron nga departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike i cili është përgjegjës edhe për hartimin e kriterëve specifike të pranimit; • Synohet në rekrutimin e një stafi me eksperiencë dhe grada shkencore, ndonëse përmbushja e saj paraqet vështirësi. • Stafi akademik me gradë shkencore angazhohet në dhënien e leksioneve dhe seminareve. • Departamenti i Inxhinierisë vë në funksion të programit të studimit një staf të kualifikuar akademik dhe ndihmës-mësimor. 	

- Në programin e studimit *Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike*, gjatë vitit akademik 2017 – 2018, mbi 86% e orëve në auditor mbulohe nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë.
- Ngarkesa mesimore është e percaktuar qarte sipas direktivave të ngarkesës të miratuara në Senatin Akademik
- Tezat e diplomës kryhen nën një udhëheqje të specializuar për fushën në të cilën tema trajtohet. Temat janë në përputhje me kërkesat e vetë tregut të punës dhe specializimit që synon vetë studenti. Udhëheqesit e temës janë me gradën Prof. Asoc ose Dr., dhe me përvojë në fushën e studimit. Numri i pakët i studentëve ofron edhe cilësi të punës në drejtim të udhëheqjes së studentit.

Mbeshtetur me siper GVJ vlereson se:

Standardi II.1 - mendojmë se përmbushet;

Standardi II.4 - mendojmë se përmbushet;

Standardi III.5 – mendojmë se përmbushet;

Standardi III.6 - mendojmë se përmbushet;

Standardi III.7 – mendojmë se përmbushet;

Standardi III.8 – mendojmë se përmbushet;

Standardi III.9 - mendojmë se përmbushet;

GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Universiteti “Epoka” zotëron një infrastrukturë të gjerë dhe të pershtatshme për të zhvilluar mësimdhënien për programin e studimit Master i Shkencave ne “Inxhinieri Kompjuterike”. Në total përbehet nga një kampus i madh me një sipërfaqje 67,000m². Programi i studimit Master i Shkencave ne “Inxhinieri Kompjuterike” zhvillohet në godinen E të inxhinierisë. Planimetria e kësaj ndërtese është dhënë në Aneksin 34 ndonëse shpjegimet perkatese jane në gjuhën turke. Në kampus është i vendosur edhe konvikti që shërben për akomodimin e studentëve.

Godina e Inxhinierisë dhe e Arkitekturës kanë një infrastrukturë moderne dhe sistem qendror ngrohje dhe ftohje. Nga vizita në terren evidentuam si më poshtë vijon:

1. Klasat për leksione dhe seminare janë të përshtatshme për të përballuar fluksin e studentëve;
2. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe smart board;
3. Klasat, laboratorët dhe ambjentet e brendshme jane të lidhura me një sistem HVAC që siguron një komfort teknik të duhur sipas standarteve;
4. Klasat jane të ndricuara mirë dhe në korridore dhe holle janë të vendosur skemat e evakuimit dhe të emergjencës.

5. Secili laborator përbehet nga dy mjedise: mjedisi për zhvillimin e kuadrit teorik ku evidentuam 1 projektor dhe 1 smart board dhe në mjedisin e zhvillimit të laboratorit ku ishte vendosur 1 projektor për pasqyrimin e qartë të rasteve studimore me tematikën që zhvillohet në laborator.

Në shtator 2013 ka perfunduar ndërtimi i Godinës A “Objekti social-kulturor i Universitetit EPOKA”. Gjate vizitës në mjedise konstatuam mjedise rekreative të mjaftueshme për studentët. Menca, biblioteka, ambjente sportive dhe clodhje ishin të pranishme në cdo godinë. Biblioteka është e vendosur në godinen e Arkitektures. Frekuentimi në këtë mjedis ishte shume akiv nga studentët. Biblioteka sherben si një ambjent shumë i frekuentuar jo vetëm për libra por edhe për shoqërim. Interneti është i aksesueshem në cdo mjedis. Punimet e studentëve ishin të vendosur edhe ne mjediset e perbashketa si në holle dhe korridore duke shërbyer si një platforme ekspozimi të punimeve vetjake te tyre dhe duke krijuar një urë komunikimi midis studenteve në programe të ndryshme studimi si psh të inxhinierike kompjuterike me atë arkitekturoe dhe të ndertimit etj. **[vizite ne terren];**

Per programin e studimit Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike jane vënë në dispozicion:

- a. 3 laboratore kompjuterike me kapacitet secili perkatesisht 43, 42, 41 studentë;
- b. 1Laborator elektronik me kapacitet 24 studentë;

Këto laboratorë përdoren edhe per programe të tjera studimi në degët e tjera të inxhinierise si Arkitekture dhe Ndërtim. Universiteti “EPOKA” ka një sallë konferencash me sipërfaqe 128 m² dhe një me kapacitet 99 persona. Salla e konferencave përdoret më shumë për evente sociale, kulturore dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Salla është e pajisur me sistem qendror për ngrohje-ftohje, videoprojektor, sistemi audio dhe dy kabina për përkthim simultan. Gjithashtu, në ambientet e "Objektit social-kulturor", është një sallë konferencash me sipërfaqe rreth 400 m² dhe kapacitet 300 persona. Ne viziten ne terren u shoqeruam nga perfaqesues te Zyres se Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ZKTIK) .Kjo zyre perbehet nga tre specialist dhe nje pergjegjes zyre. ZKTIK ofron shërbime informatike që i nevojiten Universitetit.

Disa nga shërbimet që ofrohen/administrohen nga Zyra e Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ZKTIK) janë:

- Softueri Turnitin që ndihmon për të kapur dhe shmangur plagjiaturën, si dhe zhvillon aftësitë për të cituar burime si pjesë e një argumenti akademik.
- Sistemi i Menaxhimit të Mësimin (LMS) i bazuar në Moodle që iu ofrohet studentëve dhe pedagogëve me qëllim aksesin, koordinimin dhe organizimin në internet të materialeve të lëndëve.
- Sistemi i Automatizuar i Bibliotekës (Koha) që përdoret si burim i hapur nga qindra bibliotekë në mbarë botën. Përdoruesit mund të konsultojnë libra në internet dhe t'i rezervojnë përmes uebit.
- Repositori institucional i Universitetit “EPOKA” DSpace që përdoret për krijimin e repositorëve të hapur për materiale kërkimore. Nga ky repositor mund të aksesohen konferencat e organizuara nga Universiteti “Epoka”. Gjithashtu, revistat shkencore ndërkombëtare mund të publikojnë artikujt e tyre në këtë repositor.
- Sistemi Informatik i Edukimit (Kurrikul) – faqe interneti që përmban informacion në lidhje me programet, kurrikulën dhe syllabuset e lëndës.

- Sistemet Interaktiv Epoka (EIS) Këto sisteme iu shërbejnë studentëve, pedagogëve dhe personelit. Ato ofrojnë shërbime për pranimet, regjistrimet, ndihmën financiare, llogaritë e studentëve dhe personelit, etj.

Një vëmendje të vecantë në viziten në terren u bë në bibliotekën e universitetit. Biblioteka ka një kapacitet prej 100 vendesh dhe sipërfaqe përdorimi prej 322 metra katror .Kjo bibliotekë zotëron një numër të madh librash për inxhinierinë kompjuterike dhe elektronike. Në total kjo bibliotekë zotëron 7,200 libra. Librat janë të renditura nëpër rafta sipas metodës së klasifikimit LC (system amerikan). Pasurimi i bibliotekës me libra bëhet mbi bazën e kërkesave që vijnë nga departamenti dhe nga donacionet. Njesia baze percakton edhe librat që nevojiten të blihen për te përmbushur kërkesat e studenteve dhe të stafit akademik. Departamenti cdo vit mbush një formular me listën e librave që kërkon dhe e con për miratim në Rektorat. Ky i fundit pas miratimit angazhon personat përkatës që merren me procesin e blerjes së tyre. Kostoja e literatures teknike në gjuhën angleze është e madhe. Aktualisht për vitin 2016 dhe 2017 janë blere 21 libra të rinj që shërbejnë për fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe elektronike si më poshtë vijon **[dokumente shtese: Lista e librave te blere]:**

- Computer Organization and Embedded Systems
- Computer Architecture, Sixth Edition: A Quantitative Approach
- (The Morgan Kaufmann Series in Computer Architecture and Design)
- Computer Organization and Architecture, Global Edition
- Modern Processor Design: Fundamentals of Superscalar Processors Paperback
- Parallel Computer Organization and Design
- Introduction to Algorithms
- Softëare Engineering
- Softëare Engineering: A Practitioner's Approach
- Introduction to Java Programming and Data Structures, Comprehensive Version
- Applied Medical Image Processing, Second Edition: A Basic Course
- Hands-On Machine Learning ëith Scikit-Learn and TensorFlow:
- Concepts, Tools, and Techniques to Build Intelligent Systems
- Data-Driven Modeling & Scientific Computation: Methods for Complex Systems & Big Data
- Guide to Medical Image Analysis: Methods and Algorithms
- Electromagnetic Waves
- Engineering Electromagnetics
- Antennas and Wave Propagation
- The Art of Electronics
- Microelectronic Circuits
- Control Systems Engineering
- Signals and Systems: A MATLAB® Integrated Approach
- Signals and Systems

Universiteti "EPOKA" është anëtar me të drejta të plota në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët dixhitale e krijuar në vitin 1995 që përmban më shumë se 2,000 revista akademike.

Biblioteka ka të qartë në rregulloren e saj mënyrën e qarkullimit të librave. Studentët Bachelor, Master, Doktoratë si dhe personeli akademik dhe administrativ janë anëtarë të bibliotekës. Ata mund të huazojnë materialet e bibliotekës në përputhje me rregullat.Koha e huazimit për studentë

në Master është 15 ditë dhe numri maksimal i librave që studenti mund të huazoje është 3 [takim me përgjegjesin e bibliotekës]. Studentëve në Master u vihen në dispozicion edhe materiale audio-vizuale dhe koha e huazimit të tyre është 15 ditë dhe numri maksimal i tyre është 3.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit**

Ambjentet e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë (sipas RVB)

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	5	752
lasa për seminare	17	1545
Salla për aktivitete promovuese	1	128
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	2	258
Laboratorë për lëndët	3	233
Laboratorë informatike	2	174.6
Salla interneti	2	151.8
Salla për bibliotekë	1	322
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	85.2
Zyrë informacioni për studentët	2	71
Korridore/holle	25	2707.4
Mjedise sportive	5	463
Mjedise shërbimi për të tretë	1	56
Nyje hidrosanitare për studentët (ËC)	54	327.2
Nyje hidrosanitare për stafin (ËC)	35	212.1
Norma m²/për student		40.2

- Mjediset për stafin:**

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
----------------------	-------	------------

Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	5	285.5
Zyra për Administratorin e Fakultetit	1	25.4
Zyra për sekretarinë mësimore	2	60.6
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	12	328.5
Zyra për personelin akademik	40	620
Zyrë për financën	2	37
Zyrë për Njësinë e Cilësisë së Brendshme	1	50
Salla për mbledhje	2	75
Ambjente për personelin e shërbimit	11	
Ambjente për aktivitetet e Këshillit Studentor	1	30
Ambjente çlodhjeje si kafeteri/fast-food/ restorant	1	337
Norma m²/për person	23.7	
Total	234	9335.3

GVJ ndërrmori nje vizitë në terren dhe konstatoi se përshkrimet për infrastrukturën të dhënë nga GVB janë në përputhje me konstatimet e gjetura në vizitë. Vizita në infrastrukturë i përmbahej një axhende të miratuar dhe aprovuar më parë nga institucioni.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- **Lista e librave të blerë gjatë dy viteve të fundit akademike (2016-2017);**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti kryen veprimtarinë në lokalet dhe me mjetet e vëna në dispozicion nga "Turgut Özal Education" SH.A. Të gjitha hapësirat e Universitetit janë të pacenueshme siç përcaktohet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe nuk mund t'i drejtohen ose rrezikohen nga palët e treta [statuti i universitetit "Epoka", neni 9].</p> <p>Universiteti "Epoka" zotëron një sipërfaqje 64,000 m² sipas standardeve që duhet të ketë një kampus universitar. Mjediset janë në pronësi të universitetit i cili cdo vit bën përmirësimet e duhura infrastrukturore.</p> <p>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Kompjuterike" zhvillohet në ndërtesën e Fakultetit të Inxhinierisë ku janë të pozicionuar në katin e parë edhe dy laboratorët kompjuterik dhe laborator i elektronikës. Sallat e leksioneve dhe të seminareve zhvillohen në godinen e Arkitektures e cila ka një largësi prej 3 min nga godina e Inxhinierise. Në këtë godinë është e vendosur edhe biblioteka e cila shërben edhe si mjedis studimi dhe ndërveprimi me studente të tjerë.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një</p>	<p>Universiteti "Epoka" ka të shprehur në strategjinë e tij 2013-2017 edhe synimin për pasurimin e bibliotekës [strategjia 2013-2017, fq 23].</p> <p>Biblioteka zotëron 5100 libra për të gjithë institucionin. Biblioteka ka 14 couches, 6 tavolina për 48 studentë, dhe 9 tavolina për kompjuter. Në 33 raftë janë të vendosur librat sipas sistemit PC. Regjistrimi në bibliotekë, huamarrja e materialeve dhe katalogimi menaxhohen përmes sistemit të Menaxhimit të Bibliotekës Innopac. Anëtarësia është përfshirë edhe në të njëjtin server. Anëtarët mund të aksesojnë në internet përmes kartave të tyre të anëtarësimit, të dhënave të tyre, për materialet dhe periudhën e huamarrjes. Për</p>

<p>plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>menaxhimin e këtyre shërbimeve, është i dedikuar një server Unix i veçantë. Klientët mund të hyjnë në katalog përmes Java dhe mund të hyjnë edhe jashtë kampusit të universitetit [vizite ne terren, strategjia e institucionit 2013-2017, fq 28].</p> <p>Studentet e universitetit “Epoka” kane akses te drejtperdrejte për të gjitha botimet dhe publikimet e bëra në konferenca dhe seminare të organizuara nga Institucioni. Ata kanë të drejtë aksesit edhe për temat e diplomave në nivelin Master. [vizite në terren, strategjia e institucionit 2013-2017, fq 28]</p> <p>Universiteti "EPOKA" është anëtar me të drejta të plota në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët dixhitale e krijuar në vitin 1995 që përmban më shumë se 2,000 revista akademike [takim me pergjegjesin e bibliotekes]</p> <p>Për pasurimin e bibliotekës ndiqet e një procedurë e qartë që buron nga njësia bazë deri në vendimmarjen përkatese nga Rektorati. Pasurimi me libra të rinj bëhet një herë në vit. Gjatë dy viteve të fundit akademike janë blerë 21 libra vetëm për inxhinierinë kompjuterike dhe elektronike [dok shtesë të marre ne vizite: Lista e librave gjatë dy viteve të fundit akademike]; .</p> <p>Biblioteka është e hapur nga e Hëna deri të Premten në orarin 08.30 - 12.30, 13.30 – 19.30 dhe të Shtunën nga ora 09.00-13.00 të cilat janë të përshtatshme për studentët e këtij program studimi [vizitë në terren].</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Bazuar në të dhënat e RVB dhe vizitës sonë në Unversitetin ”Epoka” GVJ vlerëson se institucioni ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa e zyra për realizimin e Programit të Studimit Masterit i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike.</p> <p>Tre laboratorë kompjuterikë janë në shërbim të aktiviteteve të programit. Ata janë të pajisur me të gjitha pajisjet dhe programet e</p>

<p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>nevojshme për realizimin e Programit të Studimit Masterit i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me kompjuter, videoprojektor dhe dërrasë interaktive. Laboratorët dhe pajisjet elektronike të teknologjisë së informacionit mirëmbahen nga zyra e ZKTIK-së. Softuerët në këta laboratorë përditësohen çdo semestër bazuar në kërkesat e stafit akademik. Laboratorët janë në përmirësim të vazhdueshëm për sa i përket pajisjeve të nevojshme për realizimin e programit kryesisht nëpërmjet projekteve të ndryshme të fituara nga departamenti ku zhvillohet programi [vizitë në terren, takim me shefin e departamentit të inxhinierisë kompjuterike].</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti “Epoka” zotëron në pronësi të saj një mjedis me një sipërfaqje 64.000 m² e cila është në përputhje me standartet e ndërtimit duke ofruar një mjedis mësimdhënie dhe rekreacioni të përshtatshëm për një kampus studentor.
2. GVJ përmes vizitës në terren pati mundësinë të verifikojë infrastrukturën që zotërohet për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” dhe gjeti një përputhje të plotë të përshkrimit të bërë në RVB me mjediset përkatëse aktuale në terren.
3. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike zotëron 3 laboratorë kompjuterike dhe 1 laborator elektronik që garanton edhe praktikën e duhur për studentët në këtë program studimi.
4. Institucioni zotëron një bibliotekë të pasur dhe ndjek një procedurë të qartë për të siguruar një aksesueshmëri dhe një mobilitet të librave në të gjithë studentët. Pasurimi i saj buron nga kërkesat e departamentit [takim me stafin akademik dhe studentët).

Mbeshtetur me sipër GVJ vlereson se:

Standardi II.5- mendojmë se përmbushet;


Standardi V. 1- mendojmë se përmbushet;

Standardi V. 2 - mendojmë se përmbushet;

GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore




Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti EPOKA është person juridik dhe një institucion laik. Universiteti EPOKA është themeluar nga Shoqëria "Turgut Özal Education" SH.A., një person juridik privat, i themeluar në bazë të ligjit shqiptar civil dhe komercial dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K12125004O [**statuti i institucionit neni 1**].

Autonomia financiare garantohet me të drejtën:


- a) të krijojë të ardhura të ligjshme nga veprimtaria e mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve etj;
- b) të marrë fonde nga shteti dhe organizatat e tjera;
- c) vendosjen e rregullave të brendshme në lidhje me përdorimin e të ardhurave financiare;
- d) përcaktimin e tarifave të shkollimit;
- e) të administrojë pasurinë e luajshme dhe të paluajshme në dispozicion për realizimin e misionit të saj.

Autoritetet drejtuese që garantojnë edhe sigurinë financiare të investimeve janë:

- Bordi i Lartë Administrativ i cili është organi më i lartë kolegjal i cili garanton përmbushjen e misionit, qëndrueshmërinë administrative dhe financiare të institucionit. Bordi Administrativ mbikëqyr dhe kontrollon aktivitetet e Universitetit lidhur me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe asetet e saj. Anëtarët e Bordit Administrativ emërohen nga Bordi Mbikëqyrës i Shoqërisë Themelues për një periudhë prej pesë vjetësh dhe mund të riemërohen. Bordi Administrativ përbëhet nga pesë anëtarë. Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Themelues emëron Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Bordit Administrativ në mesin e anëtarëve të tij për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë riemërimi. Detyrat e Bordit Administrativ janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit.
- Administratori i Universitetit i cili në detyrën e tij ka zbatimin e direktivave të dhëna nga Bordi i Administrimit; Detyrat e tij janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit, neni 61;
- Administratorë të njësisë bazë (departamenteve). Detyrat e tyre janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit, neni 63;

Shumica e të ardhurave të Universitetit "Epoka" vjen nga Bordi i Lartë i Universitetit. Një pjesë e buxhetit përdoret për të paguar pagat e stafit. Pajisjet e konsumit dhe materialet harxhuese, pajisjet dhe investimet e ndërtimit janë të mbuluara nga buxheti i shtuar i përgjithshëm. Edhe pse Bordi i Lartë i Universitetit po mbështet shumë buxhetin dhe financimin, këto burime nuk janë të mjaftueshme në krahasim me nevojat e Universitetit. Universiteti Epoka duhet të punojë më shumë për të siguruar burime shtesë si universitetet e tjera. Një nga metodat për të gjeneruar të ardhura është përmes kapitalit qarkullues. Kapitali qarkullues përbëhet nga të ardhurat që vijnë nga shërbimet e ofruara për shoqërinë. Kapitali qarkullues është burimi kryesor i të ardhurave në financimin e arsimit, hulumtimit dhe aktiviteteve shoqërore. Kapitali jashtë kapitalit qarkullues është i përbërë nga tarifatat e shkollimit të nxënësve dhe të ardhurat speciale. Edhe pse ato nuk mund të përbëjnë një sasi të konsiderueshme në të ardhurat totale të universitetit, në shërbimet e mirëmbajtjes ato mund të përbëjnë një burim të rëndësishëm. Tarifatat e shkollimit të studentëve paguhen në baza semestrale. Të ardhurat e tjera vijnë nga burime të tjera si donacionet dhe kontributet. Zyra e Rektorit ka në plan dhe koordinon ndarjen, shpërndarjen dhe shpenzimin e burimeve nga zyra administrative dhe financiare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim per vitin akademik 31,801,666 lek
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 405,492,395 lek
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 1,330,000 lek

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Buxheti i nevojshëm i investimeve për Universitetin është miratuar nga Bordi i Lartë i Universitetit Epoka. Buxheti i Universitetit Epoka është i përbërë nga buxheti i shtuar i përgjithshëm, tarifat e shkollimit të studentëve, të ardhurat e tjera të gjeneruara dhe të hyrat nga sponsorët. Bazuar ne RVB dhe nga diskutimet e bera me grupe te interesit, te ardhurat kryesore jane nga tarifat e shkollimit te studenteve. Per programin e studimt Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike numri i studenteve eshte i vogel por shpenzimet mbulohen nga vete institucioni. Te dhenat ne RVB pasqyrojne të ardhurat e Universitetit "EPOKA" në Lekë (ALL) gjatë 6 viteve të fundit, dhe shpenzimet e Universitetit "EPOKA" gjatë 6 viteve të fundit.

Grantet për kërkim dhe kontratat përbëhet nga fondet e tre viteve të fundit akademike; *Grantet për kërkim dhe kontratat* e vitit akademik 2015-2016 përfshin fondet nga dy projekte në kuadër të Erasmus+: "Mbështetje strategjike për forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri" (QAinAL) dhe "Njohuri për një shoqëri të qëndrueshme" (K – FORCE). *Grantet për kërkimin dhe kontratat* e vitit akademik 2016-2017 përfshin fonde nga të njëjtat dy projekte në kuadrin e Erasmus+: QAinAL dhe K – FORCE. *Grantet për kërkimin dhe kontratat* i vitit akademik 2017-2018 përfshin fonde nga QAinAL, K – FORCE, Projekt i Zhvillimit dhe Zbatimit të Kurrikulave Multimedia dhe TV Dixhitale (DIMTV) si dhe Vlerësim Risku i Integruar Biomaterial i Personalizuar dhe/ose i Përgjithësuar (PANBioRA) – projekt i Horizon2020.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk ka dokumentacion të marrë gjatë vizitës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Universiteti EPOKA është themeluar nga Shoqëria "Turgut Özal Education" SH.A., një person juridik privat, i themeluar në bazë të ligjit shqiptar civil dhe komercial dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K12125004O [statuti i institucionit neni 1]. Universiteti "Epoka" është subjekt i auditimit të jashtëm. Duke konsideruar që është degë e veprimtarisë së kompanisë "Turgut Özal Education" SH.A, ajo është pjesë e auditimit të jashtëm që i bëhet kompanisë së sipërcituar. Shoqëria auditohet për të gjithë të dhënat financiare që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpenzimet dhe të ardhurat e shoqërisë dhe institucioneve të përfshira, • të gjitha të dhënat kontabël lidhur me të ardhurat (grantet, tarifat e studentëve) • dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë të direkt ose indirekt (duke kontraktuar shoqëri). <p>Nuk kemi të dhëna në lidhje me raportet financiare të auditimit të jashtëm dhe analizimin nga ana e tyre e eficiencës së përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni në Statutin e tij ka të përcaktuar qartë rolin e organeve bazë kolegjiale që garantojnë autonominë financiare dhe qëndrueshmërinë e saj. Bordi i Administrimit merret me hartimin e raporteve financiare të cilat më pas i bashkangjiten raporteve të themeluesve të këtij institucioni përkatesisht Shoqëria "Turgut Özal Education" SH.A. Për programin e studimit Master iShkencave në Inxhinieri Kompjuterike evidentojmë që shpenzimet tejkalojnë të ardhurat nga tarifat e studentëve të regjistruar në këtë program. Gjithsesi universiteti mbulon këto shpenzime dhe e konsideron një pjesë të rëndësishme vazhdimësinë e këtij program studimi për të ardhmen e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike. Kjo shpreh qartë një vision dhe një stabilitet financiar që zotërohet nga ky universitet.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti "Epoka" ka të institucionalizuar organet bazë që garantojnë autonominë dhe qëndrueshmërinë financiare të tij;
2. Universiteti është subjekt i auditimit të jashtëm, por nuk jemi në gjendje të përcaktojmë rolin e raportet financiare të auditimit të jashtëm dhe analizimin nga ana e tyre e eficiencës së përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.
3. Universiteti "Epoka" shpreh një stabilitet financiar që mbulon humbjet e paraqitura në programin e studimit;

Mbeshtetur më sipër GVJ vlerëson se:

Standardi II.9 - mendojmë se përmbushet;

Standardi VI.1 - mendojmë se përmbushet;

GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Universiteti "Epoka" ka të ngritur një sistem aktiv të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sistemi i brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është i sanksionuar edhe në Statutin e Universitetit.

Sistemi i brendshëm i cilësisë mbështet punën e institucionit në drejtim të përmbushjes së misionit dhe qëllimit të tij. Ngritja institucionale e tij vjen si rrjedhojë e kërkesave që vijnë nga:

- Standardet Kombëtare të Akreditimit (Standardet e Cilësisë Shtetërore / Kodi i Cilësisë);
- Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Zonën e Arsimit të Lartë Evropian (ESG) (si një pikë referimi të jashtëm);
- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve;
- Rritja e nevojës për teknologji ose aftësi të reja që duhet të mësohen ose kompetencat;
- Nevojat e tregut të punës dhe nevojat e studentëve;
- Përgjigjet e pranuar nga Studentët e tanishëm;
- Feedback marrë nga Alumni.

Ngritja dhe funksionimi i këtij sistemi rregullohet hollësisht me Udhëzimin "Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin EPOKA", i miratuar nga Senati i Universitetit "EPOKA" në vitin 2009

Sistemi i Brendshëm i Cilësisë në Universitetin "Epoka" përbëhet nga:

1. Bordi i Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë (7 anëtarë të Senatit Akademik)
2. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë(11 anëtarë)
3. Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (7anëtarë)

Detyrat e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe të Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë janë të sanksionuar në Statutin e Universitetit "Epoka" përkatësisht në nenin 35 dhe 36 të tij.

Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë tashmë ka në përbërjen e tij komisionet e mëposhtme:

1. Komisioni i Korigjimit të Provimeve (3 anëtarë)
2. Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave (4 anëtarë)

Anetaret e NJSBC zgjidhen me vendim Senati Akademik. Universiteti "Epoka" në vite ka bërë ndryshime në lidhje me detyrat dhe funksionimin e sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Në vitin 2017 përmes vendimit të Senatit Akademik në Dhjetor 2017 ndryshon emertesën e Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë (KPSC) në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë.

KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, realizon seminare trajnimi dhe informimi periodike për personelin e institucionit, në lidhje me komponentët e ndryshëm të cilësisë dhe rëndësinë që ka sigurimi e cilësisë në përgjithësi dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë në veçanti. KPSC organizoi më 6 mars 2017 "Trajnimin e mësimdhënies për personelin Akademik" dhe më 9 tetor 2017 organizoi "Trajnimin kërkimor për personelin akademik" [takim me NJSBC].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

NJSBC vlerëson çdo lëndë në fund të çdo semestri, duke përdorur anketën e miratuar për vlerësimin e kurseve dhe mësimdhënies. Anketa e vlerësimit të instruktorit/lëndë (Instructor/Course Evaluation Survey) është burimi kryesor për mbledhjen e informacionit nga studentët në lidhje me performancën dhe cilësinë e programit të studimit. Pyetsori ka përmbajtje standarde dhe konsiston në vlerësimin e 14 treguesve nga ana e studentit.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Universiteti "Epoka" përmes zyrës së NJSBC ndërmerr në fund të çdo semestri akademik anketim të studentëve në lidhje me cilësinë e programit të studimit. Anketimi me studentët bëhet në formë elektronike ku ruhet konfidencialiteti i tij. Në lidhje me këtë në takimin me përfaqësues të zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u shpreh puna që duhet të bëhet më tej për përmirësimin e tij. Në takimin me studentet e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike u përmend puna që bëhet nga NJSBC, dhe një nga format e saj, ata sollën në shembujt e tyre anketimin e bërë për çdo lëndë në fund të çdo semestri. Plotësimi i tij është detyrues për çdo student nëse kërkon të shohë në sistem notën përfundimtare të tij për lëndët përkatëse semestrale. Rezultatet e anketimeve mbledhen nga Zyra e Regjistrimit. Me përfundimin

e anketës, sistemi elektronik nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog si rezultat i përgjithshëm, si edhe rezultatin për çdo komponent të anketimit, duke treguar edhe renditjen e pedagogëve në nivel Departamenti dhe Fakulteti.


Kjo zyrë ja percjell të dhënat Rektorit dhe ky i fundit ja delegon KPSC. Mbi bazën e të dhënave NJSBC dhe PSC hartojnë një raport përfundimtar ku shprehen problematikat dhe të dhënat perpunuese. Raporti shpreh rekomandimet përkatëse të cilat zbatohen në nivel fakulteti dhe departamenti. Raporti i KPSC paraqitet edhe në Senatin Akademik. Kryetari i KPSC është njëkohësisht edhe anëtar i Senatit Akademik. Raporti është edhe baza e përmirësimit të kurrikulave në program studimi.

NJSBC koordinon punën e saj me departamentin e Inxhinierise Kompjuterike për matjen e cilesisë së mësimdhënies. Një mekanizëm tjetër vlerësues që përdoret për të plotësuar vlerësimin e lëndës dhe vlerësimit të mësuesve është forma e vlerësimit të mësimdhënies (Teaching Evaluation Form). Shefi i Departamentit të Inxhinierise Kompjuterike në bashkëpunim me NJSBC punojnë ngushtë për zbatimin e kurrikulës dhe programeve të kurseve. Në këtë kontekst, ata si vëzhgues bëjnë vizita në klasa në mënyrë të rastësishme dhe plotësojnë një formular vlerësimi të mësimdhënies. Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet që Universiteti “Epoka” periodikisht dhe në përputhje me kalendarin e akreditimit dhe riakreditimit të Universitetit dhe të programeve të veta të studimit, harton raporte vetëvlerësimi sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë dhe sipas udhëzimeve që merr nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Bazuar në RVB, dhe në takimin e bërë me përfaqesues të Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë evidentojmë që sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përfshin punën e njësisë bazë deri në marrjen e vendimeve përkatëse në nivel Senati Akademik.

Organigrama e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur përmes përgjigjes së pyetjeve të bëra në lidhje me punën e njësisë përbërëse të këtij sistemi.



Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike, në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e departamenteve, merr informacion të rregullt bazuar në anketat e mësimdhënies për kënaqësinë e studentëve dhe merr masa për të rritur më tej cilësinë e procesit të mësimdhënies. Në përfundim të çdo semestri, pas përfundimit të anketave nga ana e studentëve, rezultatet tregohen në Sistemin Interaktiv të Epokës dhe në bazë të kësaj, Lektorët me vlerësime më të ulëta thirren për të komunikuar me Dekanin e Fakultetit mbi problemet e hasura gjatë semestrit dhe në lidhje me çështjet e theksuara nga sondazhet e studentëve. Qëllimi është të rritet cilësia e mësimit, të sigurohet një komunikim më i mirë me nxënësit dhe të përmirësohet aktiviteti mësimor. Në takimin me NJSBC dhe takim me shefin e departamenti të Inxhinierisë Kompjuterike nuk u paraqitën shembuj të largimit të stafit për performancë të dobët.

Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike shqyrton rezultatet e formave të kontrollit të lektoreve dhe të dhënat përpunohen duke hartuar edhe rekomandimet përkatëse. Nga takimet e bëra rekomandimet kanë konsistuar në përmirësimin e kurrikulës dhe ky përmirësim kryhet nga Komisioni i zhvillimit të Kurrikulës. Rezultatet e anketimeve u paraqitën edhe studentëve për të përfutur edhe feedback nga ana e tyre. Ky proces është i vazhdueshëm dhe në përmirësim.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion


Nuk ka dokumentacion të marre në vizite

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka të institucionalizuar Sistemin e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në Statutin dhe në Strategjinë e Zhvillimit të tij. Përfaqësimi i këtij sistemi buron që nga niveli i vendimarrjes që është Senati Akademik deri në nivel departamenti dhe përkatësisht për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike në nivel departamenti të inxhinierise kompjuterike.</p> <p>Si metodologji vlerësimi përdoren:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetsor për studentët [aneks 13:formë vlerësimi e lëndës] 2. Anketimi për formën e mësimdhënies nga ana e lektorëve [aneks 23: teacher evaluation form] <p>Si instrumenta matës përdoren të dhënat e mbledhura nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimi i studenteve në fund të cdo semestri; 2. Pyetësorë drejtuar studentëve 3. Analizim të rezultateve; 4. Raporte vjetore që përmbajnë analiza të aspekteve akademike dhe të dhëna për performancën e studentëve. <p>Informacioni i mbledhur nëpërmjet vlerësimeve periodike mbi efikasitetin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative të Universitetit përfshihet në raportin e vetëvlerësimit.</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave që është pjesë e NJSBC bazuar mbi të dhënat e mbledhura në bashkepunim me departamentin e Inxhinierise Kompjuterike ndërmerr edhe hapat përkatëse në lidhje me përmirësimet e duhura në kurrikul ose në format e mësimdhënies.</p> <p>Anketimet e studentëve bëhen online. Raportet e vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm janë të publikuar edhe në faqen web të universitetit.</p> <p>Nga takimet me stafin akademik, studentët dhe përfaqesues të Zyres së Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë evidentojnë format e mëposhtme të</p>




<p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>vlerësimit të cilësise së programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike:</p> <p>a. Metoda të tërthorta</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtjen e lëndës • Performancën e instruktorit të lëndës • Shërbimin e ofruar nga IAL • Rekomandime nga studentët. <p>b. Metoda të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjimi në auditor • Vlerësimi me pikë i pjesëmarrjes së studentit në orët e mësimit; • Vlerësimi me notë dhe pikë; • Vlerësimi i detyrave të realizuara nga studenti; • Vlerësimi i përfshirjes së studentëve në aktivitete jashtëshkollore;
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>NJSBC është aktive në Universitin "Epoka". Ajo organizon në fund të cdo semestri anketime tek studentët rezultatet e të cilave bëhen transparente dhe publikohen në website te universitetit. NJSBC organizon edhe trajnime si "Trajnimin e mësimdhënies për personelin Akademik" në datë 6 Mars 2017 dhe më 9 tetor 2017 organizoi "Trajnimin kërkimor për personelin akademik". Të gjithë aktivitetet e saj janë të pasqyruara në link: http://aeqi.epoka.edu.al/cat-activities-411.html</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë harton një raport vjetor që i paraqitet Senatit Akademik dhe Rektorit të Universitetit. Ky raport përmban të dhenat e përpunuara nga anketimet, trajnimet dhe seminarët e organizuara nga NJSBC dhe rekomandimet përkatëse.</p> <p>Rekomandimet e KPSC u paraqiten edhe Dekanit te Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike. Ky në bashkëpunim me stafin akademik dhe shefin e departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike ndërmerr edhe masat e duhuara për përmirësimet e nevojshme në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Universiteti "Epoka" ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 92, date 20.10.2017.

Universiteti "Epoka" ka institucionalizuar një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilesise në Statutin e Universitetit dhe në Rregulloren e Departamentit të Inxhineirise Kompjuterike, ne Strategjine e Zhvillimit të Universitetit 2013-2017 dhe në Strategjinë e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike 2017-2020.

Universiteti "Epoka" në bashkëpunim me Universitetin e Salzburg-ut, Austri ka marrë pjesë në projektin "Mbështetje strategjike për fuqizimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri" ERASMUS +.

Ndër detyrat kryesore të këtij projekti (T teor 2015 – Tetor 2018) kanë qenë:

- Sigurimi i ngritjes së kapaciteteve për sigurimin e cilësisë;
- Sigurimin e trajnimeve për hartimin e programit të studimit të bazuar në nevojat e tregut të punës.
- Hartimin e nje plan veprimi që do të mbështesin proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit në mësimdhënie, mësimnxënie dhe trajnimin e administratës
- Modernizimin e infrastrukturës së Sigurimit të Cilësisë[raporti vjetor 2015-2016 fq 56].

Bazuar në eksperiencat e fituara në projekte, mbi kerkesat e paraqitura nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Universiteti "Epoka" ka ngritur struktura që garantojnë cilesinë e mësimdhënies në nivel departamenti dhe hartimin e politikave të duhura ne nivel vendimarrje në drejtim të garantimit të cilësisë së programeve të studimit. Institucioni përdor mekanizma formal për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron, si kontrolle në auditor nga drejtues të njësisë bazë ose kryesore, përdorimin e pyetësorëve për të vlerësuar elementë e mësimdhënies, etj

KPSC organizon trajnime me synimin që të rritet ndërgjegjësimi për sigurimin e cilësisë. Personeli

dhe studentët ftohen rregullisht të bëhen pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm për të garantuar cilësinë e programeve të studimeve. Në guidën studentore dhe të stafit shprehet gjithashtu rëndësia e cilësisë në mësimdhënie dhe sigurimit të saj.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Universiteti “Epoka” është ri-akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për riakreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike”.
- Universiteti “Epoka” ka ngritur nje strukture solide dhe gjithpërfshirëse që garanton sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike.
- Universiteti “Epoka” ndërmerr metodologji dhe përdor instrumenta matës te drejtpërdrejtë dhe të terthorta për të monitoruar peocetin e mesimdhënies.
- Institucioni shpreh aftësinë a analizimit të të dhënave të mbledhura duke i shprehur ato në raporte periodike dhe vjetore te shoqeruara me rezultate dhe rekomandime përkatëse të cilat ndikojnë në permiresimet e duhura në kurrikul dhe në programin e studimit në tërësi.

Standardi I.10- mendojmë se përmbushet

Standardi I.13- mendojmë se përmbushet

Standardi II.7- mendojmë se përmbushet

Standardi VIII.1- mendojmë se përmbushet

GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike u shërben studentëve të diplomuar të cilët kanë një Bachelor në Inxhinierinë Kompjuterike ose një diplomë universitare ekuivalente me qëllim që të forcojnë njohuritë dhe të kuptuarit e parimeve dhe praktikave të inxhinierisë kompjuterike. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është i organizuar sipas sistemit me kohë të plotë [aneks 25: Rregullore e MSC Kompjuterike].

Programi konsiston në 120 ECTS dhe kurrikula propozohet nga departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike me vendim të Këshillit të Fakultetit dhe miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit "EPOKA". Programi konsiston në 10 lëndë, një punim dhe teza e Masterit që realizohet në fund të programit të studimit të ciklit të dytë. Gjatë vitit akademik duhet të merren të paktën 60 ECTS [aneks 25: Rregullore e MSC Kompjuterike]. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e përcatuar qartë në Rregulloren e programit.

Qëllimi i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri më të thelluara dhe më të gjera dhe aftësi që iu mundësojnë të përshtaten në mjedisin akademik sfidues në Shqipëri, ë jenë të përgatitur për tregun e punës në Shqipëri dhe jashtë shtetit.

Misioni: synon që studentët të kuptojnë thellësisht bazat e inxhinierisë kompjuterike, në mënyrë që të mund të zhvillojnë zgjidhje për problemet e Inxhinierisë Kompjuterike dhe të rrisë aftësitë e tyre në fushën e shkencave kompjuterike, arkitekturën kompjuterike, projektimin dhe analizën e algoritmeve, si dhe aftësitë e komunikimit dhe kërkimit në inxhinierinë e softuerëve.

Fusha e punësimit:

- Të diplomuarit e këtij programi do të jenë në gjendje të punësohen në shoqëri konsulence, institucione shtetërore dhe sistemin bankar; duke gjykuar nga natyra e fushës, presim që të krijojnë shoqëritë e tyre ose të bashkëpunojnë në hapjen e tyre.
- Programi është i dedikuar kryesisht për studentët që aktualisht janë ose synojnë të vazhdojnë studimet e doktoratës, të vazhdojnë më vonë në akademi, institute kërkimore, ose të ushtrojnë profesionin si inxhinierë kompjuterikë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Kohëzgjatja normale e programeve të studimeve të nivelit të dytë është dy vite akademike ose katër semestra dhe metoda e studimit është me kohë të plotë.

- 1 vit akademik ka 640 orë mësimore në auditor
- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë javën e provimeve të fundit
- 1 semestër ka 320 orë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 orë mësimore në auditor, përfshirë javën e provimeve të fundit
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60 '

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë jepet ne aneks.

Forma e studimit të Programit të Ciklit të Dytë në Inxhinieri Kompjuterike është me kohë të plotë. Programi konsiston në 10 lëndë, një punim dhe teza e Masterit që realizohet në fund të programit të studimit të ciklit të dytë. Procesi i mësimdhënies përbëhet nga leksione, punime dhe detyra shtëpie, praktika, seminare dhe punime të ngjashme të parashikuara në programin e lëndës.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike e leksioneve, punimeve dhe projekteve të kërkimit, praktikave, seminareve dhe punimeve të tjera të ngjashme bëhet me njësinë matëse orë auditori. Vlera e krediteve të një lëndë përbëhet nga totali i të gjitha orëve teorike javore dhe gjysmën së orëve javore për aplikim, laborator, projekte dhe atelie. Gjatë vitit akademik duhet të merren të paktën 60 ECTS.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Bazuar ne dokumentin shtese "Kurrikula e Msc" te marre gjate vizites jepet:

• Për leksionet	480 orë në auditor dhe	770 orë punë e pavarur e studentit
• Për Seminaret	32 orë në auditor dhe	30.5 orë punë e pavarur e studentit
• Për Labororet	288 orë në auditor dhe	274.5 orë punë e pavarur e studentit
• Për Praktikën lëndore	0 orë në auditor dhe	1125 orë punë e pavarur e studentit
• Për Praktikën Profesionale	0 orë në auditor dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
• Provimi përfundimtar	22 orë në auditor dhe	450 orë punë e pavarur e studentit

Mënyra e përcaktimit të ECTS jepet në Supplementin e Diplomës ku jepet struktura e programit të studimit sipas Vendimt Nr. 15, datë 04.04.2008 "Për organizimin e programeve studimore në institucionet publike të arsimit të lartë". Në këtë kontekst, numri ECTS i përshkruar në Shtojcën e Diplomës për çdo lloj aktiviteti formues jepet në lidhje me përqindjen e përafërt (dhe jo të saktë) të përcaktuar në Direktivën Nr. 15 [**dok shtesë: shpjegime në lidhje me mënyrën e përcaktimit të ECTS**).

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara
Ndryshimet jepen ne aneks.

Ndryshimet në planet mësimore bëhen në përputhje me politikën e përmirësimit të kurrikulës që ndiqet nga departamenti i inxhinierisë. Këto ndryshime janë reflektim i mendimit të studentëve i përthitur përmes sondazheve të kryera në çdo semestër, studimit të tregut të punës dhe eksperiencës së marrë nga kërkimi shkencor dhe eksperiencia e stafit akademik.

Gjatë 6 viteve akademike janë bërë ndryshimet e mëposhtme në lëndët me zgjedhje:

- Studim në Grup dhe Kërkim i Mbikëqyrur me 7.5 ECTS
- Studim i pavarur dhe kërkim i mbikëqyrur – me 7.5 ECTS
- Tema të veçanta në Inxhinieri Kompjuterike me 7.5 ECTS

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Bashkangjitur jepen tabelat

Evidentojmë që ngarkesa e stafit akademik për këtë program nuk është e madhe. Në vite sic jepet edhe në tabela bashkangjitur në aneks kemi angazhimin e stafit në përputhje me fushën e studimit. Në cdo vit akadmeik janë trajtuar lëndë ku janë angazhuar staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm sipas profilit akademik përkatës.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset permbajne ne teresi te gjithe elementet e meposhtem per cdo lende.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë të ndertuara qartë. Ato janë të aksesueshme në link <http://eis.epoka.edu.al/curricula/11/program>. Permbajtja e tyre eshte e qartë për cdo temë dhe forma e organizimit të orës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Kurrikula e Msc.
- Shpjegimi mbi ECTS
- Informacion mbi perlllogaritjen e ECTS
- Syllabuset ne ECTS

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është akredituar për herë të parë me Urdher Nr.286 datë 07.06.2012 të MASH. Programi është i organizuar në module dhe një projekt semestral. Numri i krediteve për çdo modul

<p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>të këtij programi dhe projektin semestral është 7.5 ECTS.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 2 vite studimi/4 semestra, me 120 ECTS në total. Për këtë evidentojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) 7.5 ECTS ose 6.25% • Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) 45 ECTS ose 37.5% • Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integrale (C) 15 ECTS ose 12.5% • Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) 7.5 ECTS ose 6.25% • Njohuri të tjera formuese , graduate project (E) 15 ECTS ose 12.5 • Teza e Diplomës (F) 30 ECTS ose 25%
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave ne Inxhinieri Kompjuterike ofron njohuritë më të thelluara teorike dhe praktike në fushen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimit të të dhenave (database systems) 2. Rrjetat dhe siguria (netëork & security); 3. Bioinformatikë; <p>Në fund të vitit të parë studenti ka thelluar njohuritë e tij teorike dhe praktike (përmes orëve laboratorike) në lëndët e formimit bazë (kategoria A) dhe në disiplinat e formimit karakterizues (kategoria B) dhe në lende të ngjashme dhe integrale(kategoria C). Këto zënë edhe 56,25% të totalit të krediteve.</p> <p>Në vitin e dytë akademik ne semestrin e parë evidentojmë një profilizim të formimit të tij. Nga takimet me stafin akademik, studentet dhe shefin e departamentit të inxhinierisë kompjuterike, trajtimi i lëndëve bëhet në varësi të temës së diplomës që studentin synon dhe për këtë përveç lëndës me zgjedhje studentin duhet të marrë edhe 2(dy) lëndë detyruese sipas fushave në përputhje me temën e diplomës. Lëndët</p>

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

detyruese dhe me zgjedhje janë në fushat përkatësisht:

1. Matematika për informatikë

- Matematika e avancuar për shkencat kompjuterike
- Metodatat e avancuara numerike

2. Teori

- Teoria e llogaritjes
- Algoritmet e rastësishme
- Algoritmet e avancuara dhe datastrukturat

3. Menaxhimi i të dhënave

- Sistemet e menaxhimit të databazave të avancuara
- Tërheqja e informacionit
- Menaxhimi i njohurive
- Nxjerrja e të dhënave

4. Rrjeti dhe Siguria

- Koncepte të avancuara në rrjete kompjuterike
- Rrjetet pa kordon
- Siguria e rrjetit
- Siguria e informacionit dhe forensika kompjuterike
- Programimi i rrjeteve

5. Bioinformatika


- Nanoshkenca dhe nanoteknologjia
- Bioinformatika
- Nanobiomaterialet
- Inxhinieria e indeve

Për vitin akademik 2017 – 2018 lëndët me zgjedhje kanë qenë në fushën e Bioinformatikës, përkatësisht për:


1. Nanoshkenca dhe nanoteknologjia
2. Bioinformatika;

Përgatitja e temës së diplomes trajtohet vecantë dhe vlerësohet me 30 ECTS. Në fund të semestrit të katërt studenti bën edhe mbrojtjen e temës së tij përpara një komisioni të posacem. Temat e diplomave kanë qenë në varësi të kërkesave të studentëve për profilimizim në punën e tyre, ose në pershtatje me kërkesat e tregut të punës. Kjo u theksua edhe në takimin me studentët. Kryesisht synohet në fushën e menaxhimit të të dhënave dhe rrjeteve të komunikimit për shkak të synimit për tu


	<p>punësuar në këtë fushë. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është thellim i njohurive të marra në Bachelor. Përputhshmëria e tij është edhe me universitetet publike. Shembuj u sollën nga dy studentë të cilët kishin studiuar Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe tashmë ndjekin studimet në Master i Shkencave.</p> <p>Kriteret e pranimit konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mesatare e larte në nivelin Bachelor për Inxhinieri Kompjuterike; • Njohje e mirë e gjuhës angleze. <p>Përgatitja teorike dhe trajtimi i tyre në orë laboratorike mundëson aftësimin e studentëve nga ana profesionale. Cdo lëndë është 7.5 ECTS ku 5 ECTS (48 orë) është trajtimi teorik dhe 2.5 ECTS ose 32 orë për semestër është ana laboratorike.</p> <p>Takimi me studentët konfirmoi synimin e një pjesë prej tyre për të thelluar studimin në doktoraturë. Shembull u sollën në takimin me studentët nga studentja që është edhe anëtare e Këshillit Studentor.</p> <p>Bazuar në citimin e bërë në RVB për synimet në këtë program <i>“.bazat e inxhinierisë kompjuterike, në mënyrë që të mund të zhvillojnë zgjidhje për problemet e Inxhinierisë Kompjuterike dhe të rrisë aftësitë e tyre në fushën e shkencave kompjuterike, arkitekturën kompjuterike, projektimin dhe analizën e algoritmeve, si dhe aftësitë e komunikimit dhe kërkimit në inxhinierinë e softuerëve.”</i>, si edhe duke konsideruar dokumentacionin përkatës të ofruar për këtë program studimi evidentojmë qe:</p>
	<p>1. Në këtë program studimi janë dhëne 5 fusha ku kemi një ndërthurje të njohurive bazë dhe atyre të specialitetit. Bazuar në trajtimin e lëndëve sipas kategorive mendojmë se përzgjedhja e lëndëve për secilën kategori nuk duhet të jetë fleksibel. Marrja e njohurive të përgjithshme (kategoria A) dhe njohurive në disiplina të formimit karakterizues (kategoria B) duhet të jenë në përputhje me përmbatjen e</p>




	<p>kurrikulës. Nuk është shumë e qartë mënyra e përzgjedhjes së tyre panvaresisht se në mbledhje u theksua që behet sipas kërkesave të studenteve.</p> <p>2. Në ditet tona është e zakonshme të shoqërojmë emërtimin “inxhinier kompjuterik” me dikë që është i specilizuar ne arkitekture hardëare design, programimin për sistemet softëare, për embedded systems ose firmëare. Bazuar në Wikipedia citojmë: <i>“Inxhinierët kompjuterik zakonisht kanë trajnim në inxhinierinë elektronike (ose inxhinierinë elektrike), softëare design, dhe integrimin hardëare-softëare në vend të të paturit vetëm inxhinieri informatike (softëare) ose inxhinieri elektronike. Inxhinierët kompjuterik janë të përfshirë në shumë aspekte llogaritëse të sistemeve hardëare dhe softëare, nga dizajni i mikrokontrolereve individuale, PC, dhe superkompjuter, në projektimin e qarqeve etj”</i></p> <p>Zakonisht detyrat që përfshijnë inxhinierët kompjuterik përfshijnë shkrimin softëare dhe firmëare for embedded systems, mikrokontrolere, dizajnin VLSI chips, dizajnin sensorë analogë, dizajnin bordë të qarqeve me sinjale të përzier dhe projektimin e sistemeve operative. Inxhinierët kompjuterik janë gjithashtu të përshtatshëm për kërkime robotike të cilat mbështeten fort mbi përdorimin e sistemeve dixhitale të kontrollit dhe monitorimit të sistemeve elektrike si motorët, komunikimet dhe sensorët”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga ana tjetër, ne besojmë që fushat e arkitekturës hardëare, hardëare-softëare co-designs duhet të jenë pjesë e kurrikulës por nuk e shohim në përmbajtje te saj. Për më tej, në opinionin tonë një program në inxhinierinë kompjuterike duhet të përfshijë fusha ne gjuhët e programimit dhe inxhinierisë, teknologjitë e programimit, analizat dhe verifikimet programuese, sistemet e




	<p>shpërndarjes, IT security etj të cilat evidentojmë që mungojnë në kurrikul.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bazuar mbi këtë përshkrim nuk kuptojmë: <p>(a) Mënyren sesi ky program përputhet me “detyrat që përfshijnë inxhinierët kompjuterik” dhe;</p> <p>(b) Pse ky profil përputhet me nevojat e tregut të punës në Shqipëri.</p> <p>Në lidhje me këtë (a) nuk shikojmë sesi fusha e bio-informatikës kontribuon në profilin e një inxhinieri kompjuterike.</p> <p>Në lidhje me pikën (b) ne mund të argumentojmë që nevojat e tregut shqiptar (dhe kudo) kërkojnë një profil që është me shumë i fokusuar mbi sistemet softëare dhe zhvillimet e tyre.</p> <p>Në konsideratën tonë kurrikula aktuale duket më tepër një kompromis midis tregut dhe nevojave të kurrikulës nga njëra anë dhe profileve të stafit akademik në dispozicion. Ne vleresojmë që departamenti thekson punësimin e stafit me doktoraturë të fituar jashtë vendit dhe për këtë arsye kjo normë është më e lartë se përputhja e profileve akademike të stafit me profilin e shkencës dhe inxhinierisë kompjuterike dhe softëare. Por, ky vendim nuk duhet të ndikojë ndjeshëm në hartimin e planprogramit të programit të studimit.</p> <p>Rekomandim:</p> <p>Rekomandojmë një rishikim të fushave të kurrikulës duke u venë theksi në specializimin e studentëve në fund të studimit të tyre në Hardëare and Computer Architecture dhe softëare;</p>
	<p>Bazuar për sa u theksua më sipër rekomandojmë që departamenti i inxhinierise kompjuterike duhet të zgjeroje ekspertizën e stafit akademik përmes punësimit të një stafi të ri me eksperiencë në fushat si gjuhët e programimit dhe inxhinierisë, teknologjitë e programimit,</p>




	<p>analizat dhe verifikimet softëare, sistemet e shpërndarjes, IT security. Ne e kuptojmë që kjo mënyrë kërkon një investim sinjifikativ (të rëndësishëm) por besojmë që është e domosdoshme për të mbështetur një program studimi sa më tërheqës i cili nga ana e tij mund të ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve të departamentit në termat e cilësisë të programit të studimit, në numrin e studentëve të regjistruar, në numrin e projekteve të kerkuara, në punësimin e tyre etj.</p> <p>Një mënyre potenciale (e mundshme) për të lehtësuar zgjidhjen e problemit është konsiderimi i përdorimit të metodave të përziera dhe aktive të të mësuarit bazuar mbi kurset ekzistuese on-line të cilësisë së lartë.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike” synon në përmbushjen e misionit dhe objektivave të vetë departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike dhe të Institucionit në tërësi.</p> <p>Mënyrat e vlerësimit të studentëve dhe tutoriatit i tyre janë të përcaktuar qartë në Rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë. Numri i pakët i studentëve mundëson një bashkëveprim aktiv student – lektor e cila u theksua edhe në takimin me studentët përmes shembujve që ata sollën.</p> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e shprehur edhe në syllabuse e cila varion në varësi të lëndës dhe mënyrës së organizimit të saj. Në disa prej tyre evidentojmë një vlerësim të provimeve të pjesshme, detyrave të kursit dhe seminareve, ndërsa në disa vëmendje i jepet projekteve të kursit.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionet ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p>	<p>Programi i studimit u theksua që është i hartuar mbi bazën e kërkesave të tregut të punës në Shqipëri, kërkesave të studentëve të diplomuar në nivelin</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Bachelor, përvojës më të mirë të Universiteteve në Rajon dhe në botë, kryesisht Amerike, Angli etj. dhe përthithjes së mendimit të kompanive të biznesit dhe institucioneve përmes të cilave Universiteti “Epoka” ka edhe marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Programi i studimit është konkurrues në Shqipëri dhe jashtë saj. Në takimet e bëra u sollën shembuj të studentëve të cilët pas mbarimit të studimeve në MSc. Inxhinieri Kompjuterike vazhdojnë ose kanë mbaruar me sukses studimet në fushën e doktoraturës në universite të njohura. Shembuj janë në Universitetin La Sapienza (Itali), Stavabger (Norvegji) etj.</p> <p>Programet e studimeve të ciklit të dytë janë hartuar në përputhje të plotë me Sistemin e Bolonjës dhe kërkesat e tij, si dhe në përputhje me udhëzimet për arsimin e lartë në Shqipëri (Udhëzimi nr. 5 datë 22.01.2008, Udhëzimi nr. 15 datë 4.4.2008 etj.).</p>
<p>Standardi L6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike synon në aftësimin profesional të studentëve. Përcaktimi i ECTS për cdo lëndë është i ndarë në aftësimin teorik dhe praktik të studentit. Në program nuk është konsideruar praktika profesionale në kompani ose institucione të huaja apo vendase. Kjo u konfirmua edhe nga studentët të cilët nuk e kërkonin për faktin e synimit sa më të shpejtë të tyre në punësim dhe se orët në laborator konsideroheshin të mjaftueshme për aftësimin në praktikë të tyre. Programi i studimit është në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim. Ky program merr në konsideratë edhe strategjitë dhe politikat e vendit dhe monitoron zhvillimin e biznesit në Shqipëri përmes</p>
<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	

marrjes së të dhënave nga institucione shtetërore si INSTAT, apo ato me të cilat bashkëpunon përmes marrëveshjeve të bashkupnimit [**takim me studentët**] .

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar dhe me gradë shkencor Dr e sipër. Të gjithë janë të përkushtuar për cilësinë e mësimdhënies.

Shifrat e paraqitura janë të mira:

- 7(shtatë) anëtarë të brendshëm të stafit akademik nga 8 gjithsej, janë të përfshirë në program;

- 87.5% e orëve të mësimit përballohen nga staf akademik me kohë të plotë;

- Raporti student-dhe supervisor i tezës është 2-3 studente për supervisor;

- Është pozitiv fakti që supervisorët e tezës janë me gradën Dr e sipër;


- Lëndët në nivelin Master janë të ofruar nga lektorë që mbajnë gradën Dr dhe me ndihmën e lektorëve asistentë dhe personelit administrative.

- Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme është e mirëpërcaktuar sipas Kodit të Punës në Shqipëri.

Institucioni përdor forma vlerësimi të stafit akademik në mësimdhënien e tij dhe në arritjet e tij shkencore. Vlerësimi i stafit akademik për performancën e tij bëhet çdo vit dhe Institucioni përdor teknika nxitje për të stimuluar veprimtarinë shkencore të stafit akademik [**takim me stafin akademik,**

shëfirin e departamentit të inxhinierisë kompjuterike, dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike] .

Gjithashtu sesionet e trajnimit për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme nga universiteti është një matës i vlefshëm për të garantuar cilësinë e



	stafit akademik dhe administrativ të programit të studimit.
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit konsideron kërkesat e tregut në Shqipëri dhe në rajon por nuk gjetëm evidencë të një studimi të mirëfilltë të tregut të punës. Studimi i fundit sic theksohet edhe në RVB është i vitit 2012 dhe vetëm po bëhet update i tij me të dhëna të marra nga INSTAT. Përmes zyres së karrierës institucioni ndjek edhe punësimin e studentëve. Duhet të pranojmë që shifrat e punësimit të studentëve për këtë program janë të kënaqshme. Megjithatë nuk jemi plotësisht të bindur që programi përputhet me nevojat e tregut të punës dhe nevojat ekonomike të zhvillimit në vend argumentimin e të cilit e kemi bërë me sipër për disa aspekte të kurrikulës. Institucioni ndjek nevojat e punëdhënësve me të cilët bashkepunon në nivelin bachelor përmes praktive profesionale.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare të vendit.</p> <p>Institucioni harton program që respekton dhe reflekton vlerat kombëtare dhe përputhet me strategjitë dhe objektivat kombëtare afatshkurtër dhe afatgjatë.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimit konsideron 15 ECTS lëndën “Graduate Project” e cila trajtohet në semestrin e tretë dhe përgatitjen e tezës së diplomës që konsiderohet 30 ECTS dhe që trajtohet e vetme në semestrin e katërt. Studenti mund të marrë tezën e Masterit pasi përfundon me sukses 90 ECTS të ngarkesës së lëndës.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Programi i studimit përmban në total 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite akademike.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me programin që në fillim të procesit mësimor. Studentët informohen gjithashtu nga secili profesor në lidhje me syllabusin e lëndës në orën e parë të saj. Informacioni i ofruar për Programin e Studimit Master Shkencor në Inxhinieri Kompjuterike, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i arritshëm nga studentët nëpërmjet faqes ueb të Universitetit "Epoka". (http://eis.Epoka.edu.al/).</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Mënyra e vleresimit dhe të drejtat e studentit për tu diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike janë të shprehur qartë në Rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë Kompjuterike dhe në Rregulloren e MSc. Informacion në lidhje me planin e diplomimit jepet edhe në suplementin e</p>

diplomës të programit të studimit.
Realizimi i punimit të diplomes është 30 ECTS dhe zhvillohet e vetme në semestrin e katërt të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit është i ndërtuar qartë në tërësinë e elementeve të tij.
 - Rekomandojmë një rishikim të fushave të kurrikulës duke u vënë theksi në specializimin e studentëve në fund të studimit të tyre në Hardëare and Computer Architecture dhe softëare;
 - Rekomandojmë që departamenti i inxhinierise kompjuterike duhet të zgjeroje ekspertizën e stafit akademik përmes punësimit të një stafi te ri me eksperiencë në fushat si gjuhët e programimit dhe inxhinierisë, teknologjitë e programimit, analizat dhe verifikimet softëare, sistemet e shpërndarjes, IT security. Ne e kuptojmë që kjo mënyrë kërkon një investim sinjifikativ (të rëndësishëm) por besojmë që është e domosdoshme për të mbështetur një program studimi sa më tërheqës i cili nga ana e tij mund të ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve të departamentit në terma të cilësisë të programit të studimit, në numrin e studentëve të regjistruar, në numrin e projekteve të kërkuara, në punësimin e tyre etj. Një mënyrë potenciale (e mundshme) për të lehtësuar zgjidhjen e problemit është konsiderimi i përdorimit të metodave të përziera dhe aktive të të mësuarit bazuar mbi kurset ekzistuese on-line të cilësisë së lartë.
 - Rekomandojmë që përmirësimi i kurrikulës duhet të shoqërohet edhe me një bazë laboratorike e cila të jetë në përputhje me njohuritë që do trajtohen.

Standardet e mësipërme janë .:

Standardi I.1- mendojmë se përmbushet

Standardi I.2- mendojmë se përmbushet kryesisht

Standardi I.4- mendojmë se përmbushet

Standardi I.5- mendojmë se përmbushet

Standardi I.6- mendojmë se përmbushet

Standardi I.7- mendojmë se përmbushet

Standardi I.8- mendojmë se përmbushet

Standardi I.9- mendojmë se përmbushet

Standardi I.12- mendojmë se përmbushet

Standardi II.6- mendojmë se përmbushet

Standardi II.8- mendojmë se përmbushet plotësisht.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi i mësimdhënies për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike është e përcaktuar në Rregulloren e MSc. [aneks 15 – Rregullore e Programit MSc, neni 26];

Ky program studimi konsiston në zhvillimin e 11 lëndëve dhe tezën e diplomës. Procesi i mësimdhënies është me kohë të plotë dhe konsiston në leksione, orë laboratorike, detyra dhe projekte kursi, provime të pjesshme etj. Të gjithë janë të përcaktuar qartë në kurrikulën e programit të studimit dhe në syllabuset për cdo lëndë [dok shtesë kurrikula e studimit, dok shtesë- syllabuset e programit të studimit].

Universiteti “Epoka” përdor sistemin amerikan për të përcaktuar kreditet e lëndës dhe aktivitetet e tjera shoqëruese të saj. Lëndët dhe të gjithë aktivitetet e tjera shoqëruese të tyre janë të shoqëruara edhe me kreditet sipas Sistemi Evropian të Akumulimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS) në mënyrë që të mundësohet njohja e tyre dhe transferimi i studentëve. Çdo vit akademik ka 60 kredite. Programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike. Niveli i suksesit i studentëve vlerësohet në bazë të provimeve gjatë semestrit; provimit përfundimtar; projekteve; punimeve kërkimore; prezantimeve dhe projekteve. Rregullorja e Msc përcakton në nenet e saj 27,28 dhe 29 detyrimet e studentit për mënyrën e frekuentimit, dhënies së provimit dhe ri-provimit. Këto janë përcaktuar qartë edhe në RVB dhe gjetëm një përputhje midis dokumentacionit dhe takimit me studentët.

Mënyra e vlerësimit jepet qartë edhe në tabelë:

Nota	Koeficienti	Pikë	Nota sipas sistemit shqiptar	Shpjegimi
AA	4.00	90-100	10	Shkëlqyer
BA	3.50	85-89	9	Shkëlqyer
BB	3.00	80-84	8	I suksesshme
CB	2.50	75-79	8	I suksesshëm
CC	2.00	70-74	7	I Suksesshëm
DC	1.50	65-69	6	Në provë
DD	1.00	60-64	5	Në provë
FD	0.50	50-59	4	Jo kalues
FF	0.00	40-49	0	Jo kalues
	0.00	00-00	0	Mosfrekuentim i lëndëve

Ndër të cilat nuk llogariten në mesatare:

I – me mangësi;
S- mjaftueshëm;
T – Tranferuar;
U – Pamjaftueshëm;
P – në vijim
EX-përfunduar nga detyrimi
NI – nuk ka frekuentuar;

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksion 480 orë
- Seminare 32 orë
- Ushtrime ëshë e ndërthurur në zhvillimin e lëndës
- Laboratore 288 orë
- Praktikë lëndore nuk ka
- Praktikë profesionale nuk ka

Tabelat jepen në aneks.

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit bëhen:

1. Provimet janë me shkrim;
2. Detyrat e kursit janë detyruese dhe vlerësimet e tyre përkatëse me pikë janë të përcaktuar në syllabus.
3. Projekti i kursit është detyrues dhe mbrohet me gojë duke vënë në dijeni instancat përkatëse dy javë përpara
4. Mbrojtja e diplomës është e përcaktuar qartë në rregullore dhe vlerësimi i saj bëhet para një komisioni. Temat e diplomave janë të aksesueshme nga të gjithë në universitet;

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët stimulohen përmes vlerësimit të pikëve në orët mësimore. Vëmendje i jepet aktivizimit të tyre në orët laboratorike. Për të mundësuar aftësimin e tyre profesional studentët bashkëpunojnë me stafin akademik në projekte kërkimore ose në referime të përbashkëta;

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Lista e publikime të stafit akademik dhe studentëve;

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet

që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedura e pranimit të studentëve për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike bëhet në bazë të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në bazë të Rregullores së MSc. Për studentet potencialë që shfaqin interes për ndjekjen e studimeve në nivelin Master i Shkencave ngrihet edhe program këshillimi. Kjo u konfirmua edhe në takimin me studentët. Informacioni jepet edhe nga zyra e pranimit. Procedura për regjistrimin e studentit dhe database/regjistri i studentit sanksionohen edhe në Rregulloren Themelore [aneks 13, neni 27, dok shtese:procedura e pranimit, vizite në sekretari]. Gjithashtu pranohen sipas datave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të gjithë aplikimet dhe bëhet shqyrtimi i tyre në departament.

Pranohen për studime studentë të huaj dhe vendas të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Kane përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Shqipëri ose jashtë (kjo e fundit e shoqëruar edhe me ekuivalentimin përkatës nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve);
2. Plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit;

Studentët që janë me rezultate të larta në provimin SAT u ofrohet edhe bursë sipas kategorive më poshtë:

- a. >1350 pike përfiton 100% bursë;
- b. 1290-1349 përfiton 75% bursë;
- c. 1220-1289 përfiton 50%

Në Rregulloren e Brendshme të Universitetit janë të përcaktuar qartë edhe kriteret e transferimit të studentëve. Transferimi lejohet për programe të të njejtit cikël studimesh. Nuk evidentuam raste të transferimit të studentëve.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Brendshme të Universitetit "Epoka" dhe në Rregulloren e programit.

Kritere të përgjithshme të pranimit:

- Kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë studentët shqiptarë dhe të huaj që kanë mbaruar një cikël studimesh të nivelit Bachelor dhe që plotësojnë standartet akademike të kriterëve të pranimit të Universitetit.
- Për studentët e huaj kërkohet edhe ekuivalentimi i diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve;

Kritere të veçanta:

- Kanë mesataren e përgjithshme të ciklit të parë të studimeve jo më pak se 7.5 nga 10.

- Kanë certifikim të zotërimit të gjuhës angleze me anë të një prej certifikatave të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë, e nivelit B2 ose më lart.
- Studentët që kanë diplomë Bachelor ose diplomë ekuivalente në disiplinën e përcaktuar nga Komiteti Shkencor i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike;
- Mesatare (CGPA) të paktën 2.50 nga 4.00 për studentët që kanë përfunduar programet e studimit Bachelor në Universitetin “EPOKA”, ose mesatare (CGPA) të paktën 7.00 nga 10.00 ose ekuivalente për studentët që kanë përfunduar programet e studimit Bachelor në IAL të tjera;
- Studentët që kanë përfunduar programet e studimit Bachelor në Universitetin “EPOKA” me mesatare (CGPA) ndërmjet 2.00 - 2.49 nga 4, apo studentët që kanë përfunduar programet e studimit Bachelor në IAL të tjera me mesatare (CGPA) ndërmjet 6.00 - 6.99 nga 10.00 paktën 7.00 nga 10.00, mund të regjistrohen në programin e studimit Master i Shkencave nëse kalojnë me sukses Intervistën Shkencore me Komisionin Shkencor të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike [Shtojca 15: Rregullorja e Programeve të Studimeve të Ciklit të Dytë, neni 12-13 Kuotat e Pranimit-Kriteret].

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve ka pësuar rritje. Evidentojmë një mesatare të lartë hyrje për vitin 2013 dhe një rënies të saj në vite. Gjatë dy viteve të fundit akademike kemi një rritje të mesatares së studentëve në hyrje përkatësisht 2.74 për vitin 2016 në 2.85 për vitin akademik 2017. Të dhënat jepen qartë në tabelën nr. 16 [RVB fq 109].

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (sipas RVB)

5 vitet e fundit nga viti kur programi është hartuar IER	Studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare (CGPA)	Studentë të diplomuar në vitin e fundit pa përsëritur vite	Nota mesatare (CGPA)
2013	10	3.16/4	4	3.86/4
2014	27	2.96/4	14	3.15/4
2015	16	2.57/4	8	3.1/4
2016	6	2.74/4	24	-
2017	20	2.85/4	12	-

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi ka luhatur. Për vitin akademik 2017-2018 kemi një rritje por numri i studentëve për vitin 2016 është i ulët. Nga ana tjetër kemi një rritje të mesatares së pranimit e cila nga 1.54/4 në vitin 2013 arrin në 2.11 në vitin 2017. Përmirësimi i politikave të pranimit të studentëve është përgjegjësi e Senatit Akademik i cili cdo vit bën përmirësimet e duhura sipas Urdherit nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe në bazë të kërkesave të vecanta të shprehur nga departamenti.

☑ Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

5 vitet e fundit nga viti kur programi është hartuar IER	Studentë të diplomuar në vitin e fundit pa përsëritur vite	Nota mesatare (CGPA)

2013	4	3.86/4
2014	14	3.15/4
2015	8	3.1/4
2016	24	-
2017	12	-

Vërejmë një rritje të mesatares së studentëve në fund të studimeve të tyre. Edhe kalueshmeria në vit nuk është 100%

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
Gjatë tre viteve akademike 2015 – 2018 nuk ka raste të transferimit të studentëve.

Të dhëna për punësimin e studentëve
Punësimi i studentëve në fund të diplomimit të tyre është i lartë. Evidentojmë këtë përqindje punësimi në vite bazuar në të dhënat e punësimit [dok shtesë].

Viti akademik	Përqindja e punësimit të studentëve në përputhje me diplomën e studimit
2013-2014	78.57%
2014-2015	85.71%
2015-2016	91.3%
2016-2017	88.89%

Numri total të diplomuarve

Viti akademik	Numri total i të diplomuarve
2012-2013	14
2013-2014	14
2014-2015	8
2015-2016	23
2016-2017	9

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Viti akademik	Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën	Përqindja e punësimit të studentëve në përputhje me diplomën e studimit
2012-2013	11	78.57%
2013-2014	12	85.71%
2014-2015	7	87.5%
2015-2016	21	91.3%
2016-2017	8	88.89%

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)


Viti akademik	<input checked="" type="checkbox"/> Numri total i të	Përqindja e punësimit te
---------------	--	--------------------------

	punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	studentëve në përputhje me diplomën e studimit
2013-2014	0	0
2014-2015	0	0
2015-2016	0	0
2016-2017	0	0

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe në Rregulloren e Msc pranohet të ndjekin studimet të gjithë studentët shqiptarë dhe të huaj që zotërojnë një diplomë nivel Bachelor në Inxhineiri Kompjuterike (kanë grumbulluar 180 kredite ECTS).</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve janë të bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi; Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe në Rregulloren e Msc. duke e përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të pranimit; <p>Në lidhje me gjuhën e huaj aplikohet niveli i ri i anglishtes miratuar me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Ri për Arsimin e Lartë të vitit 2015 dhe Udhëzimin e ri të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> Te gjithë studentët duhet të kenë zotërim të anglishtes të nivelit B2 sipas CEFR në një nga provimet e mëposhtme: (i) Cambridge; (ii) IELTS; (iii) TOEFL (iBT) (provim me internet); (iv) TOEFL (ITP) (test me shkrim); (v) TOEIC; (vi) GESE; (vii) APTIS, që është Provimi i Zotërimit të

	<p>Gjuhës angleze për Universitetin “EPOKA” dhe organizohet nga Këshilli Britanik në Shqipëri në ambientet e Universitetit. Nota kaluese është 70% .</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse Studenti ka përfunduar studimet e ciklit të parë (Bachelor) në një program studimi ku mësimdhënia kryhet e gjitha në anglisht, përjashtohet nga detyrimi për dorëzimin e këtij dokumenti. <p>Përmirësimi i politikave të pranimit të studentëve është përgjegjësi e Senatit Akademik i cili cdo vit bën përmirësimet e duhura sipas urdherave nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe në bazë të kërkesave të vecanta të shprehur nga departamenti.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka të ngritur Qendrën e Karrierës dhe të Diplomuarve e cila ofron informacion të vlefshëm në lidhje me mundësitë për punësim që vijnë nga kompani private. Shembujt përmendim si: panairi i karrierës në datë 6 Maj 2018 ku morën pjesë 60 kompani të ndryshme dhe 280 studentë. Vlen të përmendet kompani si: Vodafone, Raiffeisen Bank, Abissnet, Infosoft në fushën e inxhierisë kompjuterike, organizimi i forumeve të hapura ku për vitin akademik 2017-2018, dy përfaqësuese nga Raiffeisen Bank referuan në lidhje me mundësitë për punësim, përgatitjen e CV, mënyrën e prezantimit në intervistë etj, tregojnë punën e bërë nga institucioni në lidhje me rritjen e mundësisë së studentëve për punësim pas përfundimit të studimeve [takim me përfaqësues të qendrës së karrierës].</p> <p>Mbajtja e kontakteve me alumni shërben edhe si një mundësi tjetër për punësimin e studentëve që ndjekin programin. Alumni shërben si pika kontakti për organizimin e praktikave profesionale dhe marrjen e informacionit në lidhje me vendet vakante. Kjo shërben edhe për ata që tashme janë punësuar jashtë ose ndjekin studimet jashtë. Shembuj u sollën për lehtësimin e</p>




	<p>praktikave procedurale përmes komunikimit me ish – studentë që kishin studiuar me pare në universitete të huaja. Ata kanë dhënë ndihmë në informacion dhe lehtësia të tjera në akomodimin e studentëve të rinj [takim me zyrën e karrierës, stafin akademik].</p> <p>Studentët kanë informacion në lidhje me akredimin e programit të studimit në Master i Shkencave për Inxhinieri Kompjuterike [takim me studentët].</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe të diplomuarëve dhe zyra e regjistrimit në bashkëpunim me departamentin e inxhinierisë kompjuterike dhe zyrën e financës janë njësitë bazë për mbledhjen e informacionit në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar për cdo vit akademik dhe për numrin e studentëve të diplomuar dhe të punësuar. Universiteti “Epoka” zotëron një database për numrin e studentëve të regjistruar për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në bashkëpunim me zyrën e karrierës ndjekin ecurinë e studenteve nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e karrierës dhe të diplomuarëve shërben për mbledhjen e të dhënave në lidhje me punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve të nivelit të dytë në Inxhinieri Kompjuterike. Zyra e regjistrimit në bashkëpunim me departamentin e inxhinierisë kompjuterike ndjekin ecurinë e studentëve dhe mbajnë të dhëna në lidhje me studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme. Zyra e karrierës dhe të diplomuarve zoteron gjithashtu këto informacione.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Në takimin me studentët dhe me stafin akademik evidentojmë që gjendet një komunikim i hapur <i>lektor – studentë</i>. Studentët marrin informacion në lidhje me lëndët që përmban kurrikula e studimit, detyrat dhe detyrimet përkatëse për çdo lëndë. Këto bëhen të qarta në fillim të vitit akademik dhe në fillim të semestrit nga çdo pedagog. Gjithashtu studentët janë të qartë në lidhje me mënyrën e vlerësimit për projektet, detyrat e kursit, orët laboratorike dhe frekuentimin e leksioneve. Vlerësimin ata e marrin përmes sistemit dhe njëkohësisht kanë informacion të sanksionuar edhe në Rregulloren e Msc. në lidhje me mënyrën e rishikimit të vlerësimit të tyre. Shembuj u sollën në takimin me studentët.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Procesi i tutoriatit funksionon në këtë program studimi. Në çdo javë organizohen orë konsultuese. Numri i paket i studentëve mundëson një komunikim të hapur në çdo kohë me stafin akademik dhe vecanërisht me supervizorin e temës së diplomës. Këtë vit akademik numri i paket i studentëve ka sjellë që të jetë raporti 1 student – 1 supervisor për temën e diplomës duke sjellë edhe një rritje të cilësisë së përgatitjes.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti përmes Rregullorëve përkatësisht të brendshme ka sanksionuar kriteret e pranimit dhe të regjistrimit të studentëve. Procedura e pranimit bëhet gjithashtu në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". 2. Universiteti "Epoka" ka ngritur mekanizma brenda institucionit për të garantuar të dhëna statistikore në lidhje me ecurinë e programit të studimit, numrin e studentëve të regjistruar, mundësitë e tyre për punësim në fund të studimeve. 3. Qendra e karrierës dhe të diplomuarve shërben si bazë për aktivitete trajnuese në lidhje me përgatitjen e CV, përgatitjen për intervistë etj. 4. Ndjekja e alumni nga qendra e karrierës shërben për matjen e ecurisë së punësimit të studentëve të diplomuar dhe njëkohësisht për marrjen e ofertave në lidhje me punësimin apo ndjekjen e praktikave profesionale. 5. Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike ofron konsulta dhe ndjek ecurinë dhe progresin e studentëve në këtë program studimi. 	

Standardi IV.1- mendojmë se përmbushet;
Standardi IV. 2- mendojmë se përmbushet;
Standardi IV. 3- mendojmë se përmbushet;
Standardi IV. 4- mendojmë se përmbushet;
Standardi IV. 5- mendojmë se përmbushet;
Standardi IV. 6- mendojmë se përmbushet;
GVJ konkludon se standardet e kësaj fushe përmbushen.


KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Universiteti “Epoka” ndjek politika të qarta në lidhje me kërkimin shkencor. Statuti i Universitetit ligjëron mekanizmat dhe të drejtat e stafit akademik për kërkimin shkencor [aneks 5- Statuti, neni 103, 104 dhe 105]. Kërkimi shkencor është në objektivat e institucionit. Strategjia e zhvillimit 2013 – 2017 dhe strategjia e zhvillimit e departamentit të inxhinierisë kompjuterike fokusohen edhe në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe integritimit të studentëve në to. Universiteti “Epoka” ka ngritur në vitin 2013 Zyrën e Projekteve dhe Hulumtimit e cila bashkëvepron punën e saj me Rektorin e Universitetit dhe njësitë bazë dhe qendrat kërkimore shkencore të ngritura në to. Takimi me stafin akademik dhe përfaqësues të kësaj zyre sollën shembuj të përdorimit të nxitësve nga ana e universitetit për rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në kërkim – shkencor. Neni 104 në Statutin e Universitetit ligjëron lirinë në fushën kërkimore – shkencore për stafin akademik si edhe shërbim ndaj palës së tretë por këto të jenë të integruara me mësimdhënien dhe të shërbejnë në rritjen dhe përmirësimin e saj. Universiteti monitoron dhe ndjek progresin e stafit akademik, të departamentit të Inxhinierisë në lidhje me kërkimin shkencor. Raporte vjetore pasqyrojnë punën në këtë drejtim. Universiteti “Epoka” ngre edhe një juri në fund të çdo viti akademik që vlerëson punën dhe publikimet e stafit akademik në bazë të kriterëve të percaktuara në “Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore” dhe ofron edhe shpërblime në këtë drejtim për tre vendet e para. Universiteti në buxhetin e tij parashikon edhe mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik jashtë vendit në konferenca dhe seminare. Institucioni përdor edhe udhëzues të ndryshëm për nxitjen e publikimeve shkencore nga ana e stafit akademik. Vlen të përmendet këtu udhëzuesi “Për nxitjen e publikimeve shkencore” [Shtojca 27] I cili ndihmon stafin akademik në



lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e formularëve të aplikimit, si edhe në përpunimin e projekteve grant të miratuara (grante të brendshme dhe të jashtme).

Gama e projekteve në fushën e inxhinierisë kompjuterike është e gjerë. Evidentojmë dhe publikime të shumta të stafit akademik në revista me faktor impakti si edhe bashkëpunime me studentë në konferenca kombëtare. Informacioni në lidhje me kërkimin shkencor për programin e studimit Inxhinieri Kompjuterike është paraqitur në RVB, dhe u konkretizua edhe në takimet e bëra në institucion. Gjatë vizitës u morrën edhe dokumenta shtesë lidhur me këtë dhe të gjitha janë të aksesueshme edhe në link <http://projects.epoka.edu.al>.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike është i larmishëm. Evidentojmë angazhimin e studentëve në projekte. Kryesisht janë studentë të doktoraturës Institucioni ka në politikën e tij motivimin e stafit akademik dhe të studentëve për pjesëmarrje në aktivitete shkencore. Kjo shpjegon numrin e madh të pjesëmarrësve në konferenca (75) dhe përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor 14/219. Institucioni është vlerësuar edhe me çmime Kombëtare (në total 5). Universiteti “Epoka” financon edhe projekte të brendshme kërkimore (1 (Nubots)/ 10).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Shtojca: Lista e publikimeve të Personelit Akademik per kete program studimi
- (Shtojca: Aktivitetet shkencore të organizuara nga IAL per kete program studimi

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Departamenti i inxhinierisë kompjuterike ndjek një politikë të qartë në lidhje me kërkimin shkencor. Institucioni përdor inisiativa të ndryshme për nxitjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca ndërkombëtare dhe publikime të artikujve shkencore në revista me faktor të lartë impakti. Eksperienca e fituar përcillet në përmirësimin e kurrikulës. Departamenti i Inxhinierisë në bashkëpunim edhe me Zyrën e Projekteve dhe Huluntimit monitoron progresin në lidhje me këtë drejtim.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave zotëron mirë gjuhën angleze. Nga hulumtimi i bërë në zyren e Burimeve Njerëzore evidentuam dëshmi të njohjes së gjuhës angleze për stafin akademik. Gjithashtu theksojmë që shumica e tij janë specializuar jashtë. Angazhimi i stafit të huaj ka rritur cilësinë e mësimdhënies në këtë drejtim përmes sjelljes së përvojës dhe eksperiencave të huaja.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ofron trajnime në lidhje me kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik. Nxitja e rritjes profesionale të stafit akademik është e paraqitur në Statutin e Universitetit dhe në objektivat afatgjatë të strategjisë së zhvillimit të universitetit dhe të departamentit të inxhinierisë kompjuterike në vecanti. Në kuadrin e Projektit QAINAL i Erasmus+ JANE ofruar mundësi trajnime të stafit akademik. Mundësitë për trajnime dhe informacione lidhur me to janë të aksesueshme në link: aeqi.epoka.edu.l/cat-training-activities-1411.html</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Universiteti ndjek politikë të qartë në lidhje me kërkimin shkencor. Ky i fundit është në fokus të strategjise së zhvillimit afatgjatë të institucionit. Institucioni ndjek progresin në fushën e kërkimit shkencor nga ana e stafit akademik dhe të departamentit në tërësi. Të dhënat mbahen në një database ku informacioni i hollësishëm për një periudhë 5 – vjecare ruhet në lidhje me publikimet, konferencat dhe rezultatet e projekteve shkencore. Zyra e Projekteve dhe Hulumtimit bashkë me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mban një bazë të dhënash për projektet ku merr pjesë personeli ynë.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Institucioni ndjek politika të qarta në lidhje me kërkimin shkencor. Statuti i Universitetit ligjeron mekanizmat dhe të drejtat e stafit akademik për kërkimin shkencor. Strategjia e zhvillimit 2013 – 2017 dhe strategjia e zhvillimit të departamentit të inxhinierisë kompjuterike fokusohen edhe në rritjen e</p>	

cilësisë së kerkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe integritit të studentëve në to.

